



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORTI VJETOR

2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP

Prishtinë, shkurt 2017

Rruga Luan Haradinaj "Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000 Prishtinë

info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	6
Vizioni.....	7
Misioni.....	7
RAPORTI VJETOR I PZAP-IT PER VITIN 2016	7
Ish Kryesuesja dhe ish anëtari i PZAP-it gjatë vitit 2016	11
AKTIVITETET E PZAP-IT DHE ÇËSHTJET E VENDOSURA	13
KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it.....	15
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT	15
FUNKSIONET, PËRGJEGJËSIT DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT	16
Sekretariati i PZAP-it:	16
Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it, nën udhëheqjen e Kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për:	17
ORGANOGRAMI I PZAP-it.....	19
KOMISIONET E PËRHERSHME TË SEKRETARIATIT TË PZAP-it.....	22
KOMISIONET E PËRKOHËSHME TË PZAP-it	22
DEPARTAMENTI LIGJOR	23
AKTIVITETET LIDHUR ME BURIMET NJERËZORE TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT.....	25
AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR NEVOJA TË PZAP-IT	27
CERTIFIKIMI I SHPENZIMEVE FINANCIARE	29
Raporti i buxhetit dhe shpenzimet vjetore për vitin fiskal 2016	31
BUXHETI I APROVUAR PËR VITIN – 2016	31
Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2016	32
Struktura e buxhetit për vitin 2016.....	32
BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2016.....	33
Tabela Buxhetit dhe Shpenzimeve -2016	33
Paraqitja grafike e krahasimit të shpenzimeve të vitit 2016 me vitin 2015	34
PAGA DHE MËDITJET.....	35
Paga dhe Mëditje	35
Mallra dhe Shërbime.....	35
Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet sipas nën kodeve ekonomike	36
Buxheti dhe niveli i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike në % për ç'do tre muaj	37
Paraqitja grafike sipas kategorive ekonomike, niveli i shpenzimeve tremujore	37
PJESA PËRMBYLLËSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE	38

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuara të PZAP-it për vitin 2016	38
AUDITIMI DHE REKOMANDIMET E ZYRES KOMBETARE TË AUDITIMIT	38
TE HYRAT E PZAP-it	39
Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2009/2010	39
Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2013	40
Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014.....	40
Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit 2016	40
TE HYRAT E REALIZUARA GJATË VITIT 2016.....	41
NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE LOGJISTIKËS	42
NJËSIA E PERKTHIMEVE.....	43
NJËSIA E TRANSPORTIT	43
Të dhënat për kilometrat e kaluara dhe litrat e harxhuara për janar-dhjetor 2016 – FORD.....	44
Të dhënat për kilometrat e kaluara dhe litrat e harxhuara për janar-dhjetor 2016 - MITSUBISHI .	44
AKTIVITETET E PZAP-IT PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT	45
PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT DHE PERSONELIT TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT, NË PUNËTORI DHE TRAJNIME TË NDRYSHME.....	50
Punëtorja e organizuar nga data 24 mars 2016 deri me 27 mars 2016.....	50
Punëtorja e organizuar nga data 06 tetor 2016 deri me 09 tetor 2016	50
Punëtoritë e organizuara nga OSBE-ja për përkrahjen e PZAP-it	51
Punëtori e organizuar nga zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me reformën Kushtetuese dhe Zgjedhore.	52
GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E BULETINIT TË PZAP-it.....	54
PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT DHE PERSONELIT TË SEKRETARIATIT NË VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË DISA VENDE TË RAJONIT	55
Vizita në Republikën e Kroacisë nga data 10 – 13 shtator 2016.....	55
Vizita në Republikën e Malit të Zi nga data 14 – 17 tetor 2016.....	58
Vizita në Republikën e Maqedonisë nga data 09 – 12 dhjetor 2016	59
BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME KOMISIONIN QENDROR ZGJEDHOR -(KQZ).....	61
BASHKËPUNIM ME ORGANIZATËN PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM EUROPIAN – OSBE	62
BASHKËPUNIM ME FONDIN NDËRKOMBËTAR PËR SISTEME ZGJEDHORE - IFES	63
MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT	63

REKOMANDIMET E MISIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE NE KOSOVE DHE ADRESIMI I TYRE NGA PZAP-I	64
REKOMANDIMET E PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE, 8 QERSHOR 2014.....	67
PËRFUNDIME	70
SFIDAT	71

Lista e shkurtesave

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

SPZAP – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

PK – Policia e Kosovës

MF - Ministria e Financave

MAP – Ministria e Administratës Publike

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian

IFES – Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore

LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

LZL – Ligji për Zgjedhjet Lokale

ZRPPC - Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

SP- Subjektet Politike

KP – Kandidat i Pavarur

QNR – Qendra për Numërimin e Rezultateve

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhmin e Financave të Kosovës

SIMBNJ – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerezore – MAP

SIMR – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve

NJQH - Njësia Qendore Harmonizuese

ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

DASHC – Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil

VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni

PZAP-i është dhe synon të jete një institucioni i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ që bashkëpunon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

Misioni

PZAP-i me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akteret lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

RAPORTI VJETOR I PZAP-IT PER VITIN 2016

Raporti vjetor i punës pasqyron veprimet dhe aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP-i) në drejtim të përmbushjes së objektivave nga Plan i Vjetor i Punës për vitin 2016 dhe të objektivave të parashikuara me Planin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 - 2019.

Në baze të mandatit të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), PZAP-i, respektivisht anëtarët e PZAP-it dhe sekretariati i PZAP-it janë angazhuar me përkushtim të madh në përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të parapara me Planin e Punës për vitin 2016 dhe Planin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019.

Puna e PZAP-i kryesisht është përqendruar në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit, në hartimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjeve ndërinstitucionale, në hartimin dhe miratimin e Rregullave të PZAP-it, në hartimin dhe miratimin e

dokumentit të Planit Strategjik të PZAP-it, në hartimin e Buletinit të PZAP-it për periudhën 2009 – 2016, në organizimin e vizitave studimore për vëzhgimin e zgjedhjeve në disa vende të regjionit, në vendosjen e ankesave dhe apeleve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës e Glllogocit, zbatimin e rregullave dhe procedurave të punës për të siguruar një performancë sa më të mirë brenda përgjegjësiqe që i janë përcaktuar institucionit në bazë të LZP-së dhe në përputhje me ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Objektivat dhe aktivitetet e planifikuara janë përmbushur në përputhje me afatet kohore falë punës ekipore të anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it si dhe mbështetjes së ofruar nga partneret e PZAP-it, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) dhe Fondacioni Ndërkombëtarë për Sisteme Zgjedhore (IFES-i).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullat Zgjedhore si dhe Rregullat e PZAP-it. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka vendosur për 17 ankesa, të cilat i janë parashtruar PZAP-it në vitin 2016 lidhur me Procesin Zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të mbajtura me datën 04 dhjetor 2016 dhe raundit të dyte të mbajtur me datën 18 dhjetor 2016, i ka publikuar vendimet për to në faqen e internetit të PZAP-it, dhe ua ka dorëzuar ato palëve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa përbëhet nga:



Gyltene Sylejmani,
kryesuese



Hasan Shala, anëtar



Ymer Hoxha, anëtar



Rafet Haxhaj, anëtar



Nenad Lazić, anëtar



Fejzullah Rexhepi, anëtar



Zyhdi Haziri, anëtar



**Afijete Sada-Gllogjani,
anëtare**



Faton Ademi, anëtar



Adnan Konushevc, anëtar

Ish Kryesuesja dhe ish anëtari i PZAP-it gjatë vitit 2016



Nazmije Ibrahim, ish kryetare



Nehat Idrizi, ish anëtar

PZAP-i, përbëhet prej 10 anëtarëve përfshirë kryesuesin të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës me mandat katër (4) vjeçar. Kryesuesi i PZAP-it emërohet nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa anëtarët e PZAP-it nga mesi e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatave Themelore të Kosovës.

Në kuadër të bazës ligjore siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-56, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe kompetencave që parashihen, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin Agj.nr. 410/2014 të datës 31.10.2014, ka emëruar kryesuesen e panelit dhe 4 anëtarë të ri si dhe ka riemëruar 4 anëtarë të PZAP-it edhe për një mandat katër vjeçar, si më poshtë:

1. Nazmije Ibrahim, Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuese e PZAP- it;
2. Muhamet Rexha, Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit – Prishtinë, anëtarë (riemëruar);
3. Hasan Shala, Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit-Prishtinë, anëtarë (riemëruar);
4. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore-Prizren, anëtarë (riemëruar);
5. Nehat Idrizi, Gjyqtarë i Gjykatës Themelore-Prishtinë, anëtarë (riemëruar);
6. Zyhdi Haziri, Kryetar i Gjykatës Themelore-Gjilan, anëtarë;
7. Fejzullah Rexhepi, Gjyqtarë i Gjykatës Themelore – Ferizaj, anëtarë;
8. Afijete Sada, Gjyqtarë e Gjykatës Themelore-Gjakovë, anëtare dhe,
9. Faton Ademi, Gjyqtarë Gjykatës Themelore – Mitrovicë, anëtarë.

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit z. Nenad Lazić është emëruar anëtarë i PZAP-it me mandat katër vjeçar nga ana Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin e Agj.nr.241/2012 datë 09.11.2012, në vend të gjyqtarit Vlastimir Dimić, i cili ka dhënë dorëheqje si gjyqtarë i Republikës së Kosovës dhe si anëtarë i PZAP-it. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin Agj.nr. 584/2016 të datës 11.11.2016 ke riemëruar z. Nenad Lazić edhe për një mandat katër vjeçar.

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Z. Rafet Haxhaj është emëruar anëtarë i PZAP-it nga ana Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin GJ.A.Su.A. Nr.285/2015 të datës 18.09.2015 në vend të anëtarit Muhamet Rexha i cili është avancuar/dekretuar nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit në pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë z. Adnan Konushevc i është emëruar anëtarë i PZAP-it nga ana Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin GJ.A.Su.A. Nr.135/2016 të datës 31.03.2016 në vend të anëtarit Nehat Idrizi i cili është emëruar Kryesues i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës (KGJK-se).

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës me vendimin GJ.A.Su.A. Nr.537/2016 të datës 17.10.2016, ka emëruar gjyqtaren e Gjykatës Supreme të Kosovës Znj. Gyltene Sylejmani në pozitën e kryesueses së PZAP-it në vend të znj. Nazmije Ibrahim i cila ka përfunduar mandatin.

Përbërja e PZAP-it

PZAP përbëhet prej 10 (dhjetë) anëtarëve të panelit përfshirë këtu edhe kryesuesin.

Panelet e PZAP-it sipas LZP-së mund të mbledhen në përbërje prej së paku 3 (tre) anëtarëve.

Anëtarët e PZAP-it sipas LZP-së, gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve, deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it.

Për çdo panel caktohet një kryesues i panelit për seancën e caktuar. Kryesuesi i Panelit të PZAP-it, i ka caktuar përbërjen e paneleve sipas Rregullave dhe Procedurave të PZAP

AKTIVITETET E PZAP-IT DHE ÇËSHTJET E VENDOSURA

PZAP-i me qëllim të fuqizimit të institucionit gjatë vitit 2016 ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) takime/mbledhje të rregullta, në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë marrë vendime për çështje brenda përgjegjësisë që i janë përcaktuar institucionit në përputhje me LZP dhe në përputhje me ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës:

- Miratimi i Raportit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2015,
- Miratimi i Planit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2016,
- Miratimi i Vendimit për organizimin e punëtorisë së PZAP-it të mbajtur në Durrës nga data 24 mars 2016 deri me 27 mars 2016,
- Miratimi i Vendimit për organizimin e punëtorisë së PZAP-it të mbajtur në Durrës nga data 06 tetor 2016 deri me 09 tetor 2016,
- Miratimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të institucioneve që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore, PZAP-it, KQZ-së, Policisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Gjyqësorë të Kosovës,
- Miratimi i Vendimit për furnizim me telefona mobil për anëtarët e PZAP-it,
- Miratimi i Planit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016-2019,
- Miratimi i vendimit për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Kroacisë,
- Miratimi i vendimit për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Malit të Zi,
- Miratimi i Vendimit për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Maqedonisë,
- Shqyrtimi, miratimi dhe dorëzimi i propozimit të kërkesës së PZAP-it, drejtuar MAP-it, për përfshirjen dhe përcaktimin e titullit dhe nivelit të pagës për kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it në ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik,
- Miratimi i Qarkores Buxhetore për vitin 2017 dhe vlerësimet buxhetore për vitin 2018-2019,

- Miratimi i programit të aktiviteteve për mbështetje dhe asistencë teknike nga USAID/IFES për PZAP-in, për periudhën 30 mujore Gusht 2016 – Shkurt 2019,
- Miratimi i dokumentit të përgatitur nga IFES-i lidhur me Vlerësimin e Nevojave të Trajnimit për PZAP-in,
- Formimi i Grupit Punues për hartimin e Buletinit të PZAP-it, për proceset zgjedhore nga viti 2009 – 2014,
- Miratimi i Planit Vjetor të Punës për vitin 2017,
- Miratimi i vendimit për vizitën e një delegacioni të Sekretariatit të PZAP-it, në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) të Republikës së Maqedonisë, për të parë praktikën e mira të implementimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Rasteve në këtë institucion, por kjo vizite nuk është realizuar për arsye të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Rasteve në këtë institucion ende nuk ka qenë në funksion,
- Formimi i dy Grupeve punuese në nivel të anëtareve të PZAP-it, për të përgatitur dhe rekomanduar ndryshime të nevojshme në fushën e legjislacionit për funksionimin dhe fuqizimin e PZAP-it, si dhe adresimi i këtyre rekomandimeve përmes anëtareve të caktuar të PZAP-it në Grupet Punuese të formuara nga Presidenti i Republikës së Kosovës për Reformën Kushtetuese dhe Reformën Zgjedhore,
- Miratimi i vendimit për zgjatjen e orarit të punës për zyrtaret e sekretariatit të PZAP-it (SPZAP) për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të mbajtura me datën 04.12.2016,
- Miratimi i vendimit për pagesën e pagës shtesë për anëtarët e PZAP-it dhe zyrtaret e sekretariatit të PZAP-it për angazhimet shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të mbajtura me datën 04.12.2016,
- Miratimi i vendimit të Planit Operativ për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të mbajtura me datën 04.12.2016,
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga OSBE, me temën Përformanca e PZAP-it, për vitin 2016 dhe diskutimi i pikave më kryesore të Planit të punës së PZAP-it për vitin 2017,
- Miratimi i Rregullores Nr.05/2016 për Kodin e Mirësjelljes për Nëpunësit Civil të Sekretariatit të PZAP-it,
- PZAP-i për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të cilat janë mbajtur me datën 04 dhjetor 2016 ka pranuar 17 ankesa të cilat i ka vendosur brenga afatit ligjor me çka i ka mundësuar KQZ-së certifikimin e rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve.
- Miratimi i procesverbaleve për takimet e mbajtura nga paneli.

KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it

Me qëllim të lehtësimit të punës në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me ligj, PZAP-i ka formuar dy Komisione të Përherëshme siç janë:

1. Komisioni i Përherëshëm për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pesë) anëtarëve të panelit,
2. Komisioni i Përherëshëm për Buxhet dhe Personel i përberë prej 4 (katër) anëtarëve të panelit,

Komisioni i përherëshëm për çështje ligjore në bashkëpunim me kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it si dhe me kryesuesin e sekretariatit dhe zyrtarët e larte ligjor kanë identifikuar nevojën e përgatitjes së Rregullores për Kodin e Mirësjelljes së Nëpunësve Civil në Sekretariatit e PZAP-it, duke e përgatitur Rregulloren e cila është finalizuar dhe miratuar nga PZAP-i.

Komisioni për çështje ligjore në punëtoritë dhe në takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale lidhur me reformën zgjedhore sa i përket mandatit të PZAP-it duke bërë identifikimin e mangësive të Ligjit për Zgjedhje e Përgjithshme dhe duke i dhënë rekomandimet grupeve punuese për reformën zgjedhore dhe për ndryshimet kushtetuese.

Komisioni për Buxhet dhe personel është komision i përherëshëm i cili përbëhet nga anëtarët e PZAP-it. Ky komision në takimet dhe punëtoritë e mbajtura në mënyrë profesionale ka dhënë kontribut në çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it. Komisioni për buxhet dhe personel në vazhdimësi i përcjell dhe i mbikëqyr shpenzimet e buxhetit si dhe inkasimin e të gjitha gjobave të pa paguara nga ana e subjekteve politike.

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT

Struktura organizative e brendshme e PZAP-it, është e rregulluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, me të cilat përcaktohet funksionimi dhe përgjegjësia institucionale.

Struktura organizative e Institucionit të PZAP-it, përbëhet nga Anëtarët e Panelit si trup vendimmarrës profesional dhe nga Sekretariati i tij i cili mbështet punën e PZAP-it në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP.

FUNKSIONET, PËRGJEGJËSIT DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT

Duke u bazuar në nenin 123 të LZP-së PZAP-i, në ushtrimin e përgjegjësisë dhe funksioneve të tij ndihmohet nga Sekretariati.

Sekretariati i PZAP-it:

- pranon ankesa dhe apele gjatë procesit zgjedhor;
- arkivon të gjitha shkresat që parashtrihen në PZAP;
- Drafton/harton vendime të ndryshme;
- Me autorizim të panelit heton/mbledh fakte për vendosjen e ankesave të parashtruara në PZAP;
- Harton procesverbale për secilin rast gjatë zhvillimit të hetimeve së bashku me dëshmitë e mbledhura i prezanton para panelit;
- Harton raporte të përgjithshme për rezultatin e hetimeve;
- Harton raportet preliminare për rastet që konsiderohen nga paneli së kanë elemente të veprës penale dhe i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore të Republikës së Kosovës;
- Ofron ndihmën e nevojshme organeve të drejtësisë për ti hetuar rastet me elemente të veprës penale;
- Menaxhon dhe ekzekuton buxhetin vjetor;
- Përkthen vendimet në të gjitha gjuhët sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës;
- Mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë.


Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it, nën udhëheqjen e Kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për:

- Të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- Përgatitjen e paneleve të PZAP-it, duke siguruar së i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- Organizimin e Sekretariatit dhe zhvillimin e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it.
- Menaxhon buxhetin vjetor të PZAP-i të ndarë dhe aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e PZAP-it, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it.


Me buxhetin e propozuar për vitin 2016 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i nuk ka pasur ndryshime nga viti paraprak sa i përket numrit të aprovuar të stafit, respektivisht i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtarë të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it përfshi kryesuesin është dhjetë (10), prej tyre tete (8) janë të gjinisë mashkullore ose 80% ndërsa dy (2) janë të gjinisë femërore ose 20%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) anëtarë është i përkatësisë serbe ose 10%.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatin PZAP-it është 9 veta, prej tyre pese (5) janë të gjinisë mashkullore ose 55% ndërsa 4 janë të gjinisë femërore ose 45%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale tete (8) janë shqiptarë ose 89% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake ose 11%.



Sekretariati i PZAP-it



Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe emëron anëtarët nga mesi i gjykatësve të Gjykatës së Apelit dhe nga mesi i gjykatësve të Gjykatave Themelore që nënkupton së marrëdhënia e punës e anëtarëve të PZAP-it përfshi kryesuesin, funksionin në PZAP sipas LZP-së e kanë mandat shtesë.


Marrëdhënia e punës së personelit të sekretariatit të PZAP-it, rregullohet me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010.

Sekretariati i PZAP-it, ka këtë strukturë të brendshme të organizimit:

Sekretariati i PZAP-it, përbëhet nga zyra e kryesuesit të sekretariatit me kryesuesin dhe asistenten ekzekutive, Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili përbëhet prej 4 nëpunësve civil përfshirë drejtorin e departamentit, Departamentin Ligjorë i cili përbëhet prej 4 nëpunësve civil, drejtori i departamentit bashkë me tre zyrtarë të lartë ligjorë.

- Kryesuesi i Sekretariatit i cili është ekuivalent me pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë,
- Asistent Ekzekutiv/Arkivist,
- Udhëheqës i Zyrës Ligjore,
- Tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë,
- Zyrtar Kryesor Financiar
- Zyrtari i Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas,
- Zyrtari për Administrimin e Teknologjisë Informative dhe Logjistikë dhe
- Zyrtar i Transportit.

ORGANOGRAMI I PZAP-it



AKTIVITETET E SEKRETARIATIT TË

PZAP-it

Sekretariati i PZAP-it gjatë vitit 2016 ka mbajtur takime të rregullta mujore të cilat i kane paraprirë përgatitjes së të gjitha takimeve të PZAP-it.

Në këto takime janë shqyrtuar dhe diskutuar çështje që janë në përgjegjësitë e personelit të Sekretariatit të PZAP-it, si:

- Përgatitja e Planit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2016, dhe propozimi për miratimin e tij,
- Përgatitja dhe propozimi për miratim i Raportit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2015,
- Përgatitja e agjendave me pikat e rendit të ditës si dhe materialet e nevojshme për mbajtjet e takimeve të PZAP-it,
- Shqyrtimi dhe diskutimi i raporteve mujore të punës,
- Propozimi për miratimin e Vendimeve për organizimin e punëtorive të PZAP-it të mbajtura në Durrës nga data 24 – 27 mars 2016 dhe 06 - 09 tetor 2016,
- Propozimi për miratimin e Vendimit për furnizim me telefona mobil për anëtarët e PZAP-it,
- Propozim vendimi për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Kroacisë,
- Propozim vendimi për vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Malit të Zi,
- Propozim vendimi për vëzhgimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme Parlamentare në Maqedoni,
- Propozim i kërkesës drejtuar MAP-it për përfshirjen dhe përcaktimin e titullit dhe nivelit të pagës për kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it në ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik.
- Propozim kërkesa lidhur me përgatitjen e Qarkores Buxhetore për vitin 2017 dhe vlerësimet buxhetore për vitin 2018-2019,
- Përgatitjet e raporteve lidhur me aktivitetet e ndërmarra nga ana e përmblyesit privat, si dhe ofrimi i informatave të dhënave të nevojshëm lidhur me plotësimin e lëndëve të dorëzuara në zyrën e përmblyesit privat për procedim të mëtejshëm,
- Përgatitja teknike e draftit përfundimtar të planit strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019,
- Rishikimi i përmbushjes së aktiviteteve, punëve dhe detyrave dhe vlerësimi i performancës së nëpunësve të Sekretariatit për gjashtë mujorin e parë të këtij viti,
- Diskutimi i çështjeve lidhur me nevojën dhe arsyen e nxjerrjes së rregullave të brendshme të PZAP-it,

- Diskutimi lidhur me nevojën dhe arsyen e përgatitjes së një buletini me vendime të PZAP-it, si dhe propozimi i formave të Draft buletinit, para panelit,
- Diskutimi rreth përgatitjes së formave (shabllojeve) të Draft vendimeve, dhe propozimi i këtyre formave para panelit,
- Shqyrtimi i propozim programit të aktiviteteve për mbështetje dhe asistencë teknike nga USAID/IFES për PZAP-in, në periudhë 30 mujore Gusht 2016- Shkurt 2019,
- Shqyrtimi i propozim dokumentit lidhur me vlerësimin e nevojave për trajnime për PZAP nga IFES-i,
- Përgatitja e raportit nëntë mujor të punës Janar – Shtator për vitin 2016,
- Diskutimi lidhur me ngritjen e kapaciteteve të personelit të sekretariatit të PZAP-it, përmes trajnimeve të ndryshme,
- Diskutimi lidhur me çështjet e personelit të sekretariatit, çështjet e prokurimit, çështjet e buxhetit dhe financave, çështjet e teknologjisë informative dhe logjistikes, përkthimin e dokumenteve të PZAP-it, çështjet e transportit etj.,
- Përgatitja e planit operacional për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Glllogoc,
- Përgatitja e orarit për mbajtjen e kujdestarisë, përgatitja dhe dorëzimi i Formularëve të ankesave në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve për ti shpërndarë ato në vendvotime në ditën e zgjedhjeve, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit me institucionet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor si KQZ, Policinë e Kosovës, Prokurorinë e Shtetit, Këshillin Gjyqësorë të Kosovës, ku janë mbajtur disa takime për përgatitjen e të gjitha aktiviteteve me këto institucione, për zgjedhjet në Glllogoc, si dhe të gjitha aktivitete që kanë të bëjnë me zgjedhje,
- Përgatitja e formave të vendimeve të PZAP-it për zgjedhjet e ardhshme,
- Marrja e vendimeve për emërimin e komisioneve për inventarizimin, vlerësimin dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare,
- Mbajtja e takimeve me personelin e Sekretariatit lidhur me performancën vjetore të tyre,
- Përgatitja dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

KOMISIONET E PËRHERSHME TË SEKRETARIATIT TË PZAP-it

1. Komisioni Disiplinor i përbërë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit,
2. Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përbërë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit.

Komisioni Disiplinor është komision i përhershëm i cili përbëhet prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit i cili është formuar në përputhje me Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës, me qëllim të zhvillimit të procedurave disiplinore me rastin e shkeljeve të rënda të obligimeve të punës nga ana e nëpunësve civil të Sekretariatit të PZAP-it.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përbërë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit, i cili është formuar në përputhje me Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës, me qëllim të shqyrtimit dhe zhvillimit të procedurave për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave nga marrëdhënia e punës së nëpunësve civil të Sekretariatit të PZAP-it.

KOMISIONET E PËRKOHËSHME TË PZAP-it

1. Komisioni për Inventarizim të Pasurisë Jo financiare,
2. Komisioni për Vlerësim të Pasurisë Jo financiare,
3. Komisioni për Tjetërsim të Pasurisë Jo financiare,

Këto komisione kanë për qëllim menaxhimin dhe vlerësimin e pasurisë së PZAP-it në pajtim me aktet nënligjore të Administratës Publike.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Aktivitetet e Zyrtarëve të Departamentit Ligjorë në periudhën nga 01 Janar 2016 deri me 31 Dhjetor janë si në vijim:

- Pjesëmarrja e zyrtareve ligjore në punëtoritë e organizuara nga IFES-i me Grupin punues të PZAP-it, për përgatitjen e dokumentit të Planit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019,
- Zyrtaret ligjorë kanë përgatitur raportet mujore lidhur me aktivitetet e kryera të zyrës ligjore, të cilat janë prezantuar në takimet e rregullta të SPZAP-it,
- Zyrtaret Ligjor kanë përgatitur Draft Rregulloren për Kodin Etik dhe Mirësjelljen e Nëpunësve Civil të SPZAP-it, si dhe kanë bërë përfshirjen e rekomandimeve nga punësia e Durrësit me disa ndryshime në Draft Rregulloren për Kodin Etik dhe Mirësjelljen e Nëpunësve Civil të SPZAP-it,
- Zyrtarët ligjor kanë marr pjesë në takim me Kryesuesin e SPZAP-it, lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2015 dhe caktimin e detyrave për vitin 2016,
- Zyrtaret Ligjor kanë marrë pjesë në Komisionin e hapjes së ofertave të operatorëve ekonomik, Komisionin për vlerësimin e këtyre ofertave si dhe në komisionin për pranimin e mallit (të telefonave mobil, dhe pajisjeve të teknologjisë informative),
- Përpilimi i raporteve për pranimin e mallrave sipas specifikacionit nga ana e menaxherit të kontratës, (telefonave mobil, pajisjeve teknologjike),
- Zyrtaret ligjor kanë marr pjesë në punëtoritë e PZAP-it, të cilat janë mbajtur në Durrës dhe kanë ndihmuar në përgatitjen e punësive,
- Zyrtarët ligjor së bashku me disa zyrtarë nga sekretariati i PZAP-it, kanë bërë regjistrimin e 1256 ankesave (rasteve) të mbetura të proceseve zgjedhore 2009 – 2014 në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve – SMAA,
- Kanë përgatitur Përgjigjet në Kërkesë, për Gjykatat Themelore të Kosovës,
- Zyrtarët ligjor me qëllim të përgatitjes së historikut të PZAP-it dhe përfshirjen e këtij historiku në Planin Strategjik të PZAP-it 2016 – 2019, kanë nxjerr dhe përgatitur një raport/informate me të dhënave statistikore lidhur me numrin e përgjithshëm të vendimeve të ish-KZAP-it dhe PZAP-it, për të gjitha zgjedhjet e mbajtura nga viti 2009-2014, numrin e vendimeve të nxjerra për rinumërim dhe rivotim, numrin e vendimeve të atakuara në Gjykatën Supreme të Kosovës, kategorizimin e natyrave të ankesave për të gjitha zgjedhjet, numrin e ankesave me elemente të veprës penale të cilat janë dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit, nxjerrja e statistikave lidhur me dënimet e PZAP-it, numrin e urdhërave për ndalim që ka nxjerr PZAP-i ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje, gjobat të cilat i ka nxjerr, arkëtimi, përmbarimi, numri dhe vlera e arritur e të gjitha gjobave që janë mbledhur gjatë proceseve zgjedhore,

- Përpilimi i kërkesave, njoftimeve dhe raporteve lidhur me lëndët të cilat janë në procedurë përmbartimore,
- Zyrtarët ligjor kanë marrë pjesë në takim me kryesuesin e SPZAP-it lidhur me vlerësimin e performancës së tyre për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016,
- Zyrtarja Ligjore/e personelit, si person kontaktues i Sekretariatit të PZAP-it, ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit (AKK), lidhur me procesin e rregullt të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë të institucionit, raportimi i institucionit për pranimin e dhuratave, i cili ka rezultuar me pranimin e zero dhuratave nga ana e zyrtarëve të PZAP-it,
- Zyrtarja Ligjore/e personelit ka përfaqësuar PZAP-in, në takime dhe punëtoritë e Grupit Punues për Persona me Aftësi të Kufizuar, ku janë marrë vendime si caktimi i logos për grupin punues, dizajni për udhëzuesin për terminologji si dhe punëtorja për zhvillimin e një doracakut për inkurajimin e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në proceset zgjedhore dhe politike, pastaj çështjet rreth organizimit të lansimit të udhëzuesit për terminologji, diskutimi rreth memorandumit në mes KQZ-së dhe MASHT,
- Zyrtarja Ligjore/ e personelit ka marrë pjesë në takimet e Grupit Punues për Persona me Aftësi të Kufizuar, lidhur me përgatitjen dhe lansimin e Doracakut për Terminologjinë e duhur për personat me aftësi të kufizuar, si dhe në lansimin e Udhëzuesit për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar në Proceset Zgjedhore dhe Politike,
- Pjesëmarrja e zyrtarëve ligjorë në punëtoritë e organizuara nga OSBE me zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-it dhe të KQZ-së,
- Përzgjedhja e vendimeve për përfshirjen e tyre në Buletinin e PZAP-it, si dhe përgatitja e Formave të Draft Buletinit me vendime të PZAP-it,
- Përgatitja e formave (shabllojeve) të ndryshme të Draft vendimeve,
- Zyrtarët ligjor kanë përgatitur raportin nëntë mujorë të punës për muajt Janar – Shtator 2016, lidhur me aktivitetet e kryera të zyrës ligjore, të cilat janë prezantuar në takimet e rregullta të sekretariatit të PZAP-it,
- Zyrtarët ligjorë kanë marrë pjesë në takimet e rregullta të mbajtura me Sekretariatit dhe anëtarët e PZAP-it, në të cilat takime kanë mbajtur shënime dhe kanë përgatitur procesverbalet e takimeve,
- Përpilimi i kërkesave të ndryshme lidhur me pagesat për shpenzimet e krijuara për nevojat e PZAP-it,
- Verifikimi i listave të anëtarëve të nominuar si: Komisioni Komunal Zgjedhor, anëtarët e vendvotimeve, dhe menaxherët e qendrave të votimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit,
- Veprime administrative lidhur me hetimet e rasteve të ndryshme për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogoc,
- Hartimi i kërkesave për përgjigje në ankesë për subjektet politike të cilat janë në procedurë,

- Hetimi i të gjitha rasteve sipas ankesave të parashtruara nga subjektet politike dhe OJQ-ve me pretendimet së ka pasur parregullsi në ditën e zgjedhjeve (ditën e votimit me datën 04.12.2016 dhe balotazhit të mbajtur me datën 18.12.2016),
- Sigurimi i të gjitha materialeve të nevojshme për mbajtjen e seancës së panelit si përgatitja e draft vendimeve, referimi i lëndës para panelit gjatë mbajtjes së seancës lidhur me ankesën/apelin e parashtruar,
- Përgatitja e përgjigjeve në ankesat e parashtruara në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it,
- Njoftimi i palëve me vendimet e PZAP-it lidhur me ankesat/apelet e parashtruara në PZAP,
- Regjistrimi i ankesave dhe shkresave të lëndëve (ankesave/apeleve) të parashtruara në PZAP nga subjektet politike dhe OJQ-të në librin e Protokollit,
- Regjistrimi i ankesave dhe shkresave të lëndëve (ankesave/apeleve) të parashtruara në PZAP nga subjektet politike dhe OJQ-të në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Ankesave (SEMA) si dhe kompletimi i dosjes së lëndës në SEMA.

AKTIVITETET LIDHUR ME BURIMET NJERËZORE TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT

Për shkak të numrit të kufizuar të personelit, aktivitetet lidhur me Burimet Njerëzore i kryen zyrtarja e lartë ligjore Valbona Millaku.

- Përfundimi i procedurave të Vlerësimit të punës të zyrtareve të Sekretariatit të PZAP-it për vitin 2016, futja e këtyre të dhënave në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) të Ministrisë së Administratës Publike (MAP).
- Përgatitja e Pyetësorit lidhur me të dhënat e shërbyesve civil të Sekretariatit të PZAP-it për vitin 2016,
- Plani Vjetor i Trajnimit për shërbyesit civil të SPZAP-it për vitin 2016,
- Përgatitja e Planit Vjetor të Pushimeve Vjetore të personelit të SPZAP-it për vitin 2016,
- Dorëzimi i listës me emrat e zyrtareve të lartë publik të institucionit të PZAP-it në Agjencionin Kundër Korrupsionit, si dhe raportimi i institucionit për pranimin e dhuratave, i cili ka rezultuar me pranimin e zero dhuratave,
- Përgatitja dhe dorëzimi në DASHC/MAP i propozimit për Klasifikimin e Vendeve të Punës sipas Katalogut të vendeve të punës për nëpunësit civil të institucionit, i cili propozim është aprovuar nga DASHC/MAP,

- Përgatitja e të dhënave dhe dorëzimi i tabelave në DASHC/MAP, me të dhënat e kërkuara për nëpunësit civil të SPZAP-it,
- Regjistrimi dhe futja e të gjitha të dhënave nga dosja e personelit të nëpunësve civil të Sekretariatit të PZAP-it në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ),
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike – IKAP ka organizuar disa trajnime në të cilat janë ftuar dhe kanë marr pjesë edhe disa zyrtarë të Sekretariatit. Temat e trajnimit kanë qenë si në vijim: Përafrimi i legjislacionit vendor me atë Evropian, Sjellje organizative, Planifikimi, Rekrutimi dhe Përzgjedhja e Nëpunësve Civil, Liderhipi dhe Menaxhimi, Krijimi dhe riorganizimi i strukturave organizative të institucionit të administratës, Kodi Etik për nëpunësit civil, Planifikimi dhe Menaxhimi i IMS projekteve, Transferimi dhe Promovimi në Shërbimin Civil, si dhe trajnime lidhur me SIMBNJ,
- Pjesëmarrje në forumin e menaxherëve të personelit me temë: Diskutimi lidhur me procesin e reformave në Shërbimin Civil,
- Kërkesë për fillimin e procedurës së rekrutimit të jashtëm të pozitës së drejtorit të Zyrës Ligjore dhe njoftimi i DASHC-së, për aprovimin e tij nga MF, për pozitën e Drejtorit të Zyrës Ligjore,
- Inicimi i procedurës së rekrutimit të jashtëm, aprovimi në SIMBNJ nga DASHC, si dhe publikimi i konkursit në SIMBNJ, në shtyp dhe në web faqe,
- Përgatitja e dosjes së rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor.
- Njoftimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK-së) për fillimin e procedurës së rekrutimit të jashtëm për pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor.
- Formimi i Komisionit Përzgjedhës për Shërbimin Civil (KPSHC) në SIMBNJ për zhvillimin e procedurës së rekrutimit të jashtëm për pozitën Drejtorit të Departamentit Ligjor.
- Vazhdimi i konkursit në afat prej 7 ditëve në SIMBNJ, shtypin ditor dhe web, si dhe njoftimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në KPMSHCK për zgjatjen e konkursit,
- Kërkesa për rishpallje të konkursit për drejtor të departamenti ligjor, rishpallja e konkursit në SIMBNJ, web, shtyp si dhe njoftimi i KPMSHCK-së për rishpallje të konkursit dhe zhvillim të procedurës,
- Vazhdimi i procedurës së rekrutimit për Drejtor të Departamentit Ligjor - Njoftim i KPMSHCK-së për vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve nga KPSHCK,
- Marrja e rekomandimit nga KPMSHCK lidhur me procedurën e rekrutimit, për anulimin e konkursit për Drejtor të Departamentit Ligjor, për shkak të numrit të vogël të aplikuesëve,
- Plotësimi i tabelave sipas kërkesës së MF me titujt e punës në sistemin e pagave me të dhënat për nëpunësit civil të SPZAP-it.
- Futja e planit orientues të pushimeve në SIMBNJ për nëpunësit e SPZAP-it
- Caktimi i mbikëqyrësve të drejtpërdrejt në SIMBNJ për nëpunësit civil të SPZAP-it

- Përditësimi dhe futja e të gjitha të dhënave nga dosja e personelit të nëpunësve civil të Sekretariatit të PZAP-it në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ),
- Përpilimi i kërkesave për pushime varësisht nga kërkesat e nëpunësve civil si dhe përditësimi i dosjeve fizike dhe elektronike në SIMBNJ,
- Plotësimi i tabelës me të dhënat për nëpunësit civil të SPZAP-it, sa i përket niveleve, baza ligjore për përcaktimin e pagës, sipas kërkesës së MAP-it,
- Plotësimi i tabelës me kodet sipas departamenteve për nëpunësit civil të SPZAP-it, dhe dërgimi i tabelës në DASHC/MAP,
- Përgatitja e Planit Individual të Personelit dhe dorëzimi i tij në MAP,
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për shpalljen e dytë dhe rishpalljen e konkursit për Drejtor të Departamentit Ligjor, përgatitja e dosjes së rekrutimit si dhe njoftimi i KPMSHCK-së për zhvillimin e procedurave për rekrutim për shpalljen dhe rishpalljen e konkursit, si dhe për anulimin e konkursit, kërkesa në MEF, në DASHC/MAP përmes SIMBNJ-së, publikimi i konkurseve në shtyp, web,
- Dorëzimi i tabelave dhe dokumenteve tjera lidhur me orët shtesë për stafin, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit, për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2016, në MAP,
- Plotësimi i raportit lidhur me strukturën e të punësuarve në institucionin e PZAP-it, në baze të kërkesës së MAP-it,
- Përfundimi i procedurave të Vlerësimit të punës të zyrtareve të Sekretariatit të PZAP-it për vitin 2016,

AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR NEVOJA TË PZAP-IT

Për shkak të numrit të kufizuar të personelit, aktivitetet lidhur me Procedurat e Prokurimit i kryen zyrtarja e lartë ligjore Florije Krasniqi.

- Dorëzimi në mënyrë elektronike i Planit Përfundimtar të Prokurimit Publik të PZAP-it, për vitin fiskal 2016 në Agjensionin Qendror të Prokurimit (AQP),
- Dorëzimi i Raportit Vjetor të Prokurimit për Vitin 2015, për kontratat e lidhura në mes të PZAP-it dhe Operatorëve Ekonomik, në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP),
- Zhvillimi i aktivitetit të Prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës “Furnizim me dhjetë (10) telefona mobil për anëtarët e PZAP-it,

- Pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 05/L092 21 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 21/A paragrafi 2 i këtij ligji, për të gjitha Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Kosovës e që kanë më pak së pesëdhjetë (50) punonjës, përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit është Agjencia Qendror e Prokurimit-AQP, për arsye të ekonomizimit të shpenzimeve, ku lidhur me këtë Zyrtarja e Prokurimit ka marr pjesë në një takim me përfaqësuesit e AQP-së, si dhe me përfaqësuesit e këtyre Agjencive të Pavarura, për të arritur një marrëveshje për koordinimin e aktiviteteve të cilat do të barten në përgjegjësi të AQP-së,
- Si aktivitet tjetër me rëndësi në Prokurimin Publik të PZAP-it, ka qenë urdhër blerja për të gjitha kontratat që kemi të lidhura me Operatoret Ekonomik,
- Monitorimi dhe menaxhimi i kontratës me titull “Servisim dhe Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative të PZAP-it”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 31.12.2017,
- Monitorimi dhe menaxhimi i kontratës me titull “Sigurimi i Automjeteve të PZAP-it”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me datë 16.08.2016,
- Monitorimi dhe menaxhimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e Pastrimit dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të PZAP-it”, Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 07.03.2018,
- Monitorimi dhe menaxhimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Material Zyrtar për PZAP-in”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 26.03.2018,
- Monitorimi dhe menaxhimi i kontratës me titull “Furnizim me karburante për automjete të PZAP-it”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 19.09.2017,
- Monitorimi dhe menaxhimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Servisim i automjeteve të PZAP-it”. Kontrata është nënshkruar me 29.12.2015,
- Zhvillimi i Procedurave të Prokurimit dhe nënshkrimi si dhe monitorimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i automjeteve të PZAP-it”. Kontrata është nënshkruar me 03.11.2015,
- Inicimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të Prokurimit për furnizim me “Pajisje të Teknologjisë Informative – lloptopëve”, njoftimi për kontratë në KRPP, dorëzimi i kërkesave nga ana e operatorëve ekonomik për dosjen e tenderit, si dhe nënshkrimi i kontratës me Operatorin fitues sipas kriterëve të përzgjedhjes,
- Pjesëmarrja e zyrtares së prokurimit në trajnimin bazik të Prokurimit publik, dhe kryerja me sukses e testimit nga ana e IKAP-KRPP,
- Zhvillimi i Procedurave të Prokurimit me titull “Mirëmbajtja dhe Servisim i serverëve”, mirëpo për shkak të mos interesimit nga ana e Operatorëve Ekonomik, SPZAP-i nuk ka pranuar asnjë dosje të tenderit. Kështu që dy herë radhazi është bërë Njoftimi për Anulimin e Kontratës.

CERTIFIKIMI I SHPENZIMEVE FINANCIARE

Për shkak të numrit të kufizuar të personelit, aktivitetet lidhur me Certifikimin e dokumenteve zyrtare i kryen zyrtari i lartë ligjor Kudret Hasani.

- Gjatë këtij viti është bërë certifikimi i të gjitha shpenzimeve financiare për të gjitha shpenzimet e krijuara për nevojat e PZAP-it, si:
- Certifikimi shpenzimeve për telefona fiks për muaj,
- Certifikimi i shpenzimeve për mbushje të telefonave mobil për muaj,
- Certifikimi i shpenzimeve për blerje të telefonave mobil pe anëtarët e PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve për furnizim me pajisje të teknologjisë informative,
- Certifikimi për mirëmbajtje të zyrave të PZAP-it,
- Certifikimi për shpenzimet e energjisë elektrike,
- Certifikimi i shpenzimeve për servisim të automjeteve të PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve për furnizim me karburante për automjetet e PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve për Dreka të takimeve zyrtare të anëtarëve të PZAP-it dhe stafit të Sekretariatit dhe për pije në takimet zyrtare,
- Pagesat për përmbarimin e vendimeve me titull ekzekutiv,
- Certifikimi i shpenzimeve për udhëtime zyrtare,
- Certifikimi i shpenzimeve për pagesën e mjeteve lidhur me shpenzimet e krijuara për publikimin e konkursit për Drejtor të Departamentit Ligjor etj.,
- Certifikimi i shpenzimeve për pagesën e pajisjeve të teknologjisë informative (llaptopëve)
- Mbyllja e avanseve për të gjitha shpenzimet e realizuara për udhëtimet zyrtare jashtë vendit
- Mbyllja e petty cashit për shpenzimet e realizuara.



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

Raporti i buxhetit dhe shpenzimet vjetore për vitin fiskal 2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP) është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0160.

PZAP-i financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2016 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Baze për hartimin e dokumentit kane shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€).

Shumat raportuese janë në njësi në €.

BUXHETI I APROVUAR PËR VITIN – 2016

Me ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 05/L-011, për vitin 2016 për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndare buxhet në shumë prej 212,160 €. Me Instruksionin për Rishikim të Buxhetit që zakonisht MF e bënë pas gjashtë muajve prej fillimit të vitit Fiskal, ka pasur një ndryshim të vogël në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në shumë prej 1,861€.

Pas Rishikimit të Buxhetit, buxheti i PZAP-it ka mbetur në shumë prej 210,299€.

Shkurtime në buxhet kemi pasur edhe në fund të vitit 2016 në shumë prej 18,108.88€.

Këto shkurtime janë bërë nga MF me vendim të Qeverisë Nr. 01/123 të datës 28.12.2016, në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime si dhe në kategorinë ekonomike për shërbime komunale.

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime janë bërë kursime në shumë prej 15,206.22€, ku në fund të vitit 2016 në këtë kategori ekonomike buxheti ka mbetur në shumë prej 58,406.78€.

Në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në formë tabelore:


Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2016

Kategoria Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2016	Buxheti i ndryshuar me Rishikim të Buxhetit-2016	Buxheti i ndryshuar në fund të vitit 2016	Buxheti Përfundimtarë 2016
Paga dhe mëditje	130,727	(-1,861)	-	128,866
Mallra dhe shërbime	73,613	-	(-15,206)	58,407
Shërbime Komunale	7,820	-	(-2,902)	4,918
Total:	212,160	-1,861	-18,108	192,191

Struktura e buxhetit për vitin 2016

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në fund të vitit fiskal në shumë prej 192,191.00 € si dhe strukturën buxhetore, rezulton së prej tyre:

- 67.05 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 30.39 % të fondeve është akorduar për shpenzime për mallra dhe shërbime,
- 2.56 % për shpenzimet komunale.



BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2016

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2016, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2016 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket si në vijim:

Tabela Buxhetit dhe Shpenzimeve -2016


Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2016	Buxheti i ndryshuar në fund të vitit 2016	Buxheti i shpenzuar- 2016	Përqindja (%) e buxhetit fillestar	Përqindja (%) e buxhetit të ndryshuar
Paga dhe mëditje	130,727	128,866	127,486	97.52%	98.92%
Mallra dhe shërbime	73,613	58,407	58,407	79.34%	100%
Shërbime Komunale	7,820	4,917	4,917	63%	100%
Total:	212,160	192,190	190,810	89.9%	99.28%

Në kategorinë ekonomike e Pagave dhe Mëditjeve, nëse llogaritim shpenzimin me buxhet fillestar të aprovuar, del së 97.52% të buxhetit janë shpenzuar për paga dhe mëditje ndërsa me Buxhetin e ndryshuar gjatë vitit del së buxheti i shpenzuar për këtë kategori është 98.92%.

Në kategorinë ekonomike e Mallrave dhe Shërbimeve, shpenzimi me buxhet fillestar është 79.34% ndërsa me buxhet të ndryshuar gjatë vitit është 100% buxhetit të realizuar.

Ne kategorinë ekonomike e Shërbimeve Komunale, nëse llogaritim shpenzimin me buxhet fillestar të aprovuar, del së buxheti është shpenzuar 63%, ndërsa me buxhet të ndryshuar buxheti është shpenzuar 100%.

Paraqitja grafike e krahasimit të shpenzimeve të vitit 2016 me vitin 2015



PAGA DHE MËDITJET

Për vitin 2016 në Kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje, buxheti i aprovuar për PZAP-in ka qenë në shumë prej 130,727€. Shpenzimi i buxhetit për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje ka qenë 127,486€ apo 98.92% të buxhetit të planifikuar. Pagat neto për anëtarët e PZAP-së janë shpenzuar në shumë prej 39,757€ ndërsa pagat neto për zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-së janë shpenzuar në shumë prej 66,425€. Tatimi në paga për anëtarët dhe zyrtarët e sekretariatit në totale është 9,160€. Kontributi pensional i punëtorit në paga për anëtarët dhe zyrtarët e sekretariatit në totale është 6,071€ dhe Kontributi pensional i punëdhënësit në paga për anëtarët dhe zyrtarët e sekretariatit në totale është 6,071€.

Siç është cekur më lartë me Instruksionin për Rishikim të Buxhetit, në këtë kategori kemi pasur shkurtim të buxhetit në shumë prej 1,861€.

Këto mjete që janë shkurtuar në kategorinë e pagave dhe kanë mbetur pa u shpenzuar për arsye së ende së kemi bërë rekrutimin e Drejtorit të zyrës Ligjore.

Paga dhe Mëditje

në €

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2016
Paga dhe mëditje	127,484
Pagat neto për anëtarët e PZAP-së	39,757
Pagat neto për zyrtarët SPZAP-së	66,425
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	9,160
Kontributi pensional i punëtorit	6,071
Kontributi pensional i punëdhënësit	6,071

Mallra dhe Shërbime

Te kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime Buxheti i aprovuar në fillim të vitit ka qenë 73,613€ , në fund të vitit me Vendim të Qeverisë nr.01/123 të datës 28.12.2016 janë bërë shkurtime buxhetore në shumë prej 15,206€ .

Këto mjete u shpenzuan në shumë prej 58,407€ apo buxheti është shpenzuar 100% duke e krahasuar me buxhetin që ka mbetur në fund të vitit. Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modullit të aprovimeve dhe
- Modullit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë të prezantuara në formë tabelore shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2016.

Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet sipas nën kodeve ekonomike

Kategoritë ekonomike	Shpenzi met janar- mars 2016 në(€)	Shpenzi met prill- qershor 2016 në(€)	Shpenzi met korrik- shtator 2016 në(€)	Shpenzi met tetor- dhjetor 2016 në(€)	Shpenzi met janar- dhjetor 2016 në(€)
Mallra dhe Shërbime	4,353	17,444	13,747	22,859	58,407
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	8,035	6,032	15,127	29,194
Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit	-	-	-	555	555
Shërbimet tjera telefonike vala 900	2,200	1,650	1,650	1,100	6,600
Shërbimet kontraktuese tjera	583	-	-	-	583
Shërbimet postare	-	-	-	2	2
Furnizim me ushqim dhe pije –jo dreka zyrtare – uji i pijshëm	66	-	96	50	212
Furnizimi për Zyre	-	-	94	1,925	2,019
Furnizim me aparate të telefonave mobil	-	5,480	-	-	5,480
Karburant për vetura	106	224	119	372	821
Sigurimi i automjeteve	-	-	543	350	893
Regjistrimi i automjeteve	-	-	150	57	207
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	127	403	213	97	840
Mirëmbajtja e ndërtesave	708	807	708	708	2932
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	-	-	-	600	600
Shpenzimet për informim publik	163	161	162	707	1,193
Shpenzime- Vendimet e Gjykatave	124	94	100	65	384
Drekat zyrtare	277	590	108	914	1,893
Shërbime shëndetësore (marrje e vizave)?	-	-	53	-	53
Pajise TI – Kompjuter-Llaptop	-	-	3,010	-	3,010
Taks komunale	-	-	20	-	20
Reklama dhe konkurse	-	-	690	230	920


Buxheti dhe niveli i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike në % për ç'do tre muaj

Në tabelën e më poshtme janë të paraqitura shpenzimet për ç'do tre muaj, janar-mars, prill-qershor, korrik-shtator dhe tetor-dhjetor-2016, ku janë të pasqyruara në mënyrë analitike dhe të ndara në periudha tremujore të gjitha shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike si dhe progresi në përqindje të shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor-2016.

Në këtë raport është pasqyruar edhe Buxheti i Rishikuar që është aprovuar nga MF, si shkurtimet buxhetore që janë bërë nga MF në fund të vitit me vendim të Qeverisë Nr.01/123 të datës 28.12.2016.

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar 2016	Buxheti i shpenzuar janar-mars 2016	Përqindja (%) janar-mars 2016	Buxheti i shpenzuar prill-qershor 2016	Përqindja (%) prill-qershor 2016	Buxheti i Rishikuar 2016	Buxheti i shpenzuar korrik-shtator 2016	Përqindja (%) korrik-shtator 2016	Buxheti në fund të vitit shkurtim me vendim të Qeveris	Gjithësejt buxheti i shpenzuar janar-shtator 2016	Përqindja (%) tetor-dhjetor 2016	Gjithësejt buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2016	Përqindja (%) janar-dhjetor 2016
Paga dhe mëditje	130,727	30,335	23	30,409	23	128,866	30,409	24	127,486	36,332	28	127,485	100
Mallra dhe shërbime	73,613	4,353	6	17,448	24	73,613	13,747	19	58,407	22,859	39	58,407	100
Shërbime Komunale	7,820	131	2	147	2	7,820	170	2	4,917	4,469	91	4,917	100
Total:	212,160	34,819	16	48,004	23	210,299	44,326	21	190,810	63,660	33	190,809	100


Paraqitja grafike sipas kategorive ekonomike, niveli i shpenzimeve tremujore



PJESA PËRMBYLLËSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe databazës së Sekretariatit të PZAP-it, mund të përfundojmë së për vitin 2016, Buxheti u shpenzua **190,810€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2016.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuara të PZAP-it për vitin 2016



AUDITIMI DHE REKOMANDIMET E ZYRES KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Gjatë vitit 2016 PZAP ka pranuar për vizite auditorët nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) për Pasqyrat Financiare 2015. Rekomandimet e dala nga ZKA janë këto:

- Kryesuesi i Sekretariatit duhet të siguroj që është finalizuar dhe aprovuar plani strategjik i PZAP-it, i cili do të shërbente si dokument kornizë (bazë) për përcaktimin e planeve operative si dhe për realizimin dhe monitorimin e tyre.
- Kryesuesi i Sekretariatit duhet të siguroj që është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejt për hartimin e listës për menaxhimin e rrezikut tek pozitat përkatëse.
- Kryesuesi i Sekretariatit duhet të siguroj që të gjitha format e kërkuara plotësohen në kronologji konform rregullës së thesarit.

Nga rekomandimet e dhëna nga ZKA në Pasqyrat Financiare të vitit 2015, PZAP i ka përmbushur të gjitha gjatë vitit 2016.

TE HYRAT E PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i) në bazë të nenit 120 paragrafi 1, pika c) të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073, mund të shqiptoj gjoba ndaj një Subjekti Politik në rast së përcakton së ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së. Gjatë vitit 2015 janë ndërmarr disa aktivitete ku fillimisht është bërë rishikimi i statusit aktual të subjekteve politike që nuk i kanë shlyer borxhet nga viti 2009 e deri në vitin 2014, dhe gjetja e modalitetit për përmbarimin e borxheve. Këto aktivitete janë vazhduar edhe gjatë vitit 2016, ku me përmbaruesin privat jemi akorduar dhe jemi në proces të përmbarimit të vendimeve të PZAP-it lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike për periudhën e zgjedhjeve të vitit 2009 – 2014. Nga ky proces i përmbarimit 5 vendime janë përfunduar dhe tjerat janë në proces të përmbarimit. Në tabelat e më poshtme janë të paraqitura në mënyrë detale borxhet e SP për të gjitha vitet.

Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2009/2010

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e gjobës
1	Anr.79/2010	DRK	1,500		1,500
2	Anr.83/2010	PLK	4,800		4,800
3	Anr.81/2010	RRKPZ	4,800		4,800
4	Anr.85/2010	PRSH	1,500		1,500
5	Anr.86/2010	GIO	500	50.65	449
6	Anr.88/2010	SDP	3,200		3,200
7	Anr.90/2010	JSZH	500		500
8	Anr.91/2010	ZBB	500		500
9	Anr.92/2010	ZEG	500		500
10	Anr.95/2010	KP. Mexhit Foniqi	200		200
11	Anr.98/2010	KP. Naim Mustafa	200		200
12	Anr.99/2010	KP. Hasan Bilalli	200		200
13	Anr.426/2010	LDD	2,500		2,500
14	Anr.389/2010	FER	1,500		1,500
15	Anr.434/2010	FER	1,550		1,550
Total:			23,950	51	23,899

Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2013

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr. 300/2013	G.I Narodna Incijativa	400.00		400.00
2	Anr. 320/2013	Nisma Qytetare për Prizrenin (NQP)	250.00		250.00
Total:			650.00	-	650.00

Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr.122/2014	Grupi Tradicionale Shqiptar (GTSH)	250.00		250.00
2	Anr. 26/2014	Hajrullah Shehu-Kandidat I Pavarur	200.00		200.00
3	Anr. 27/2014	Isuf Musliu - Kandidat I Pavarur	200.00		200.00
4	Anr. 31/2014	GI. Nove Snage	1,500.00		1,500.00
5	Anr. 33/2014	KTB	3,000.00		3,000.00
Total:			5,150.00	-	5,150.00

Gjobat e shqiptuara dhe të pa paguara për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit 2016

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr.100	Partia Demokratike e Kosovës	1,200.00		1,200.00
2	Anr.101	Lidhja Demokratike e Kosovës	1,200.00	1,200.00	-
3	Anr.124	Partia Demokratike e Kosovës	3,000.00		3,000.00
4	Anr.125	Nisma për Kosovën	3,000.00		3,000.00

5	Anr.126	Nisma për Kosovën	2,500.00		2,500.00
Total:			10,900.00	1,200.00	9,700.00

***Gjithsej borxhe të papaguara për të gjitha proceset zgjedhore prej vitit 2009 - 2016 janë:
39,399€.***

TE HYRAT E REALIZUARA GJATË VITIT 2016

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP	Subjekti politik	Përshkrimi i të hyrave	Pagesa e gjobës	Data e pagesës së borxhit
1	Anr.100/2010	KP. Ahmet Krasniqi	E hyr me këst nga 37 euro të caktuar nga përmbauesi	37.50	25.01.2016
2	Anr.100/2010	KP. Ahmet Krasniqi	E hyr me këst nga 37 euro të caktuar nga përmbauesi	37.50	02.02.2016
3	Anr.93/2010	KP. Bajram Islami	E hyr me këst nga 79 euro të caktuar nga përmbauesi	79.00	02.02.2016
4	Anr.100/2010	KP. Ahmet Krasniqi	E hyr me këst nga 37 euro të caktuar nga përmbauesi	37.50	02.03.2016
5	Anr.100/2010	KP. Ahmet Krasniqi	E hyr nga shpenzimet administrative të caktuar nga përmbauesi për Ahmet Krasniqin	118.22	02.03.2016
6	Anr.93/2010	KP. Bajram Islami	E hyr me këst nga 79 euro të caktuar nga përmbauesi	79.00	04.04.2016
7	Anr.93/2010	KP. Bajram Islami	E hyr me këst nga 79 euro të caktuar nga përmbauesi	79.00	04.04.2016
8	Anr.93/2010	KP. Bajram Islami	E hyr me këst nga 79 euro të caktuar nga përmbauesi	79.00	03.05.2016
9	Anr.93/2010	KP. Bajram Islami	E hyr me këst nga 28.72 euro të caktuar nga përmbauesi	28.72	06.06.2016
10	Anr.86/2010	GIO	E hyr me këst nga 50.65 euro të caktuar nga përmbauesi	50.65	18.10.2016
11	Anr.101	LDK	E hyra nga gjobat e shqiptuara për Zgjedhjet për kryetar të Drenasit	1,200.00	28.12.2016
Total:				1,826.09	

Gjatë vitit 2016 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 1,826.09€, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

NJËSIA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE LOGJISTIKËS

Gjatë periudhës janar-qershor 2016, njësia e TI-së dhe Logjistikës ka pasur disa aktivitete:

Njësia e Teknologjisë Informative ka bërë administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve të Microsoft të ofruar nga Ministria e Administratës Publike, si dhe mirëmbajtjen e serverit të web faqes dhe Sistemit për Menaxhimin e Rasteve, serverit të domain-it (rrjetin e brendshëm).

Në funksion të përmbushjes së detyrave që ndërlidhen me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve nga teknologjia informative, janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme sipas kërkesave të zyrtarëve. Në kuadër të aktiviteteve më kryesore nga kjo njësi, është mirëmbajtja dhe azhurnimi në vazhdimësi i Web faqes së PZAP-it ku gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore janë publikuar vendime, formularë, udhëzime, raporti vjetor i punës për vitin 2015. Plani i punës së PZAP-it për vitin 2016 dhe informacione tjera që kanë qenë të dobishme për Institucionin. Gjithashtu nga kjo njësi është publikuar konkursi për pozitën e lirë Drejtor i Zyrës Ligjore. Në vazhdimësi bëhet ofrimi i përkrahjes teknike në Sistemin për Menaxhimin e Rasteve dhe Teknologjisë Informative.

Në bashkëpunim me Kompaninë Cactus është bërë Rregullimi i shfaqjes së Vendimeve në Web Faqe dhe mandej është bërë testimi i ndryshimeve në Web Faqe pas rregullimit. Janë identifikuar nevojat e PZAP-it për softuer të licencuar nga Microsoft për vitin 2017 – MAP.

Zyrtari i TI-së për shkak të numrit të kufizuar të personelit në institucion kryen edhe detyrat e zyrtarit të logjistikës, ku është bërë regjistrimi i inventarit në sistemin E-Pasuria, janë përgatitur specifikat për furnizim me aparate të telefonisë mobile për kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it, dhe janë përgatitur specifikat për furnizim me pajisje të teknologjisë informative.

Kjo njësi ka pasur edhe aktivitete tjera ndër cilat inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve të PZAP-it përmes programit E-pasuria, ku në këtë lëmi kemi pasur aktivitete ku kemi bërë vlerësimin dhe ri-vlerësimin e disa pajisjeve nga teknologjia informative. Duke u bazuar në **Rregulloren MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kemi të drejt që të bëjmë rivlerësimin e pasurisë pasi ato janë funksionale dhe në gjendje të rregullt.**

Zyrtari i Teknologjisë Informative kryen edhe detyrën shtesë të zyrtarit zotues dhe tërheqjes së parave të imta dhe përcjellja e shpenzimit me para të imta.

Kryen edhe pune tjera sipas kërkesave të menaxhmentit dhe zyrtarëve të PZAP-it.

NJËSIA E PERKTHIMEVE

Koordinatori për përkthim ka kryer të gjitha obligimet e dala nga PZAP/SPZAP, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Nga njësia e përkthimeve gjatë vitit 2016 janë kryer disa aktivitete që i përkasin këtyre njësive. Nga njësia e përkthimeve janë përkthyer të gjitha dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it si: Përkthimi i Raportit vjetor të punës 2015, Planit të punës 2016, të gjitha komentet të pranuar nga akteret e jashtëm lidhur me hartimin e Planit Strategjik të PZAP-it, përkthimi i Planit Strategjik të PZAP-it, përkthimi i agjendave dhe procesverbaleve të takimeve të PZAP-it dhe të Sekretariatit të PZAP-it si dhe dokumente të tjera sipas kërkesës së zyrtarëve. Përgatitja e disa dokumenteve për aplikim në Ambasadën e Kroacisë ku kanë marr pjesë një grup nga Institucioni i PZAP-it për vëzhgim të Zgjedhjeve Parlamentare që janë mbajtur në Kroaci.

Zyrtari i përkthimeve për shkak të numrit të kufizuar të personelit në institucion kryen edhe pune tjera shtese:

Regjistron të hyrat në Sistemin e Free Balance sipas kërkesave të Departamentit të Thesarit kur ka pasur të hyra në llogarinë e PZAP-it.

Bënë pranimin e mallit në depo, kryen edhe punët e zyrtarit pranues ku janë bërë të gjitha pranimet e nevojshme që duhet të kryhen rregullisht në bazë të procesit të realizimit të pagesave. Përpos këtyre aktiviteteve, në vazhdimësi janë kryer edhe aktivitete tjera si: kontrollimi i inventarit në depo ku për ç’do fund vit bëhet regjistrimi i të gjithë inventarit dhe i materialit administrativ që janë në depo dhe inventarit që kemi në posedim, ngarkimi i zyrtarëve me material administrativ, ngarkimi dhe shkarkimi i depos si dhe detyra tjera sipas kërkesave të zyrtarëve.

NJËSIA E TRANSPORTIT

Nga njësia e transportit gjatë vitit 2016 janë kryer të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me transport si: mbajtja e evidencave të qarkullimit të veturave zyrtare dhe evidentimi i ç’do kilometër të kaluar gjatë qarkullimit të automjeteve. Në vazhdimësi janë raportuar në mënyrë specifike për ç’do muaj edhe në formë tabelave për shpenzimet e litrave të shpenzuara për derivate si dhe kilometrat e kaluara për veturë zyrtare. Gjatë vitit 2016 për veturën zyrtare FORD janë shpenzuar 654.5 litra karburante dhe kilometra të kaluara janë 9110 km. Nga vetura zyrtare MITCUBISHI për vitin 2016 janë të shpenzuara 331 litra karburante dhe kilometra të kaluara janë 3907km.

Të dhënat për kilometrat e kaluara dhe litrat e harxhuara për janar-dhjetor 2016 – FORD

Muaji	Kilometrat e kaluar a janar-mars-2016	Litrat e harxhuara janar-mars-2016	Kilometrat e kaluara prill-qershor-2016	Litrat e harxhuara prill-qershor-2016	Kilometrat e kaluara korrik-shtator-2016	Litrat e harxhuara korrik-shtator-2016	Kilometrat e kaluara tetor-dhjetor 2016	Litrat e harxhuara tetor-dhjetor 2016	Kilometrat e kaluara janar-dhjetor 2016	Litrat e harxhuara janar-dhjetor 2016
Janar	395	41	-	-	-	-	-	-	395	41
Shkurt	452	44	-	-	-	-	-	-	452	44
Mars	1387	71	-	-	-	-	-	-	1387	71
Prill	-	-	530	45	-	-	-	-	530	45
Maj	-	-	298	42	-	-	-	-	298	42
Qershor	-	-	917	41	-	-	-	-	917	41
Korrik	-	-	-	-	295	48	-	-	295	48
Gusht	-	-	-	-	65	-	-	-	65	-
Shtator	-	-	-	-	524	40	-	-	524	40
Tetor	-	-	-	-	-	-	1835	138	1835	138
Nëntor	-	-	-	-	-	-	631	41	631	41
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	1781	103.5	1781	103.5
Total:	2234	156	1603	128	884	88	4247	282.5	9110	654.5

Të dhënat për kilometrat e kaluara dhe litrat e harxhuara për janar-dhjetor 2016 - MITSUBISHI

Muaji	Kilometrat e kaluara janar-mars-2016	Litrat e harxhuara janar-mars-2016	Kilometrat e kaluara prill-qershor-2016	Litrat e harxhuara prill-qershor-2016	Kilometrat e kaluara korrik-shtator-2016	Litrat e harxhuara korrik-shtator-2016	Kilometrat e kaluara tetor-dhjetor 2016	Litrat e harxhuara tetor-dhjetor -2016	Kilometrat e kaluara janar-dhjetor -2016	Litrat e harxhuara janar-dhjetor -2016
Janar	101	-	-	-	-	-	-	-	101	-
Shkurt	50	-	-	-	-	-	-	-	50	-
Mars	738	79	-	-	-	-	-	-	738	79
Prill	-	-	49	-	-	-	-	-	49	-
Maj	-	-	14	-	-	-	-	-	14	-
Qershor	-	-	28	-	-	-	-	-	28	-
Korrik	-	-	-	-	14	-	-	-	14	-
Gusht	-	-	-	-	648	44	-	-	648	44
Shtator	-	-	-	-	60	-	-	-	60	-
Tetor	-	-	-	-	-	-	1491	117	1491	117
Nëntor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	714	91	714	91
Total :	788	79	103	-	722	44	208	2205	3907	331

Përpos këtyre aktiviteteve nga njësia e transportit janë kryer edhe punë tjera si: përcjellje e vazhdueshme e veturave për ndonjë defekt eventual dhe dërgimi për servisim si dhe është bërë servisim i rregullt i veturave, pranimin e faturave për derivate dhe për servisim të automjeteve, pastrimin e veturave sipas nevojës, shërbimet me transport sipas kërkesave të Kryesuesit të PZAP-it, anëtarëve të Panelit si dhe zyrtarëve të SPZAP-it, shpërndarja e dokumenteve të ndryshme nëpër Institucione si dhe punë të tjera.

AKTIVITETET E PZAP-IT PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT

Pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit nga ana e Presidentit të vendit dhe caktimit të datës për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve më datën 04 dhjetor 2016, PZAP-i menjëherë ka filluar përgatitjen e Planin të Veprimit për këto zgjedhje.

Prej shpalljes së zgjedhjeve në Gllogoc, deri me certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve nga KQZ-ja, PZAP-i ka kryer aktivitetet e nevojshme brenda përgjegjësi që ka:

Ka përgatitur Planin e Veprimit për Zgjedhjet në Gllogoc me të cilin plane janë planifikuar të gjitha aktivitetet e anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të Sekretariatit të PZAP-it për këtë proces zgjedhor.

Ka miratuar Vendimin për punë jashtë orarit të punës për zyrtaret e Sekretariatit të PZAP-it.

Ka miratuar vendimin për pagesën e pagës shtese për anëtarët e PZAP-it dhe zyrtaret e Sekretariatit të PZAP-it për angazhimet shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për dite të vikendeve dhe ditëve të festave zyrtare. Zbatimi i këtij vendimi, respektivisht pagesa, është bere në përputhje me Ligjin e Shërbyesve Civil.

Personeli i Sekretariatit të PZAP-it ka shpërndarë Formularët e ankesave tek zyrtari komunal i zgjedhjeve me qëllim të shpërndarjes së tyre nëpër Qendrat e Votimit në Komunën e Gllogocit.

PZAP-i me KQZ-ne, në mënyrë reciproke, kanë pasur komunikimin dhe bashkëpunimin e zakonshëm brenda përgjegjësi që kanë me LZP-në.

PZAP-i, sipas kërkesës e ka njoftuar KQZ-në me:

Emrat e personave të cilët me vendim të PZAP-it ju është ndaluar e drejta që të jenë kandidatë për zgjedhje dhe pjesë e stafit administrativ të zgjedhjeve që organizohen nga KQZ-ja,

Me gjobat e papaguara nga ana e subjekteve politike para certifikimit të subjekteve politike dhe kandidateve për të marre pjese në garën për kryetar të komunës.

PZAP-i, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune së Glllogocit, të mbajtura me datën 04 dhjetor 2016, ka kryer me sukses funksionet dhe përgjegjësitë e tij të përcaktuar me ligj, ku për këtë proces zgjedhor në afatin e parapare ligjor ka vendosur lidhur me 17 ankesa të paraqitura nga Subjektet Politike dhe Organizatat Jo Qeveritare (OJQ), prej tyre:

Tete (8) ankesa janë të miratuara,

Pese (5) ankesa janë refuzuar,

Dy (2) ankesa janë tërhequr dhe,


Dy (2) ankesa janë të palejuara,

Një (1) vendim i PZAP-it është apeluar në Gjykatën Supreme të Kosovës i cili apel është refuzuar, respektivisht nga Gjykata Supreme e Kosovës është vërtetuar vendimi i PZAP-it.

Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave dhe marrjes së vendimit lidhur me këto ankesa për procesin zgjedhor në Glllogoc, PZAP-i sipas kërkesës zyrtare të KQZ-së të njëjtën e ka njoftuar me shkrim së mund të certifikoj rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.


Tabela me statistikat për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Glllogoc të mbajtura me 04 dhjetor 2016 dhe Raundit të dyte të mbajtur në 18 dhjetor 2016

Ankesa/Apele	Nr.	Përqindja e ankesave dhe apeleve
Ankesa	15	88.24%
Apele	2	11.76%
Totali:	17	100.00%




Llojet e vendimeve të PZAP-it

Marrja e vendimeve	Nr.	Përqindja e llojeve të vendimeve
Vendime të refuzuara	5	29.41%
Vendime të miratuara	7	41.18%
Ankesa të tërhequra	2	11.76%
Vendim ankesa hidhet si e palejuar	2	11.76%
Vendim aprovohet pjesërisht / Hedhet si e palejuar	1	5.88%
Totali	17	100.00%



Ankesat sipas Fazave Zgjedhore

Faza e zgjedhjeve	Nr.	Përqindja ankesave sipas fazave zgjedhore
Dita e zgjedhjeve	9	52.94%
Fushata zgjedhore	2	11.76%
Heshtja zgjedhore	3	17.65%
Periudha parazgjedhore	3	17.65%
Totali	17	100.00%




Vendimet me Gjobë

Vendimet me Gjobe	Ankuesi	E Paditura
Vendimi Anr.100	KDI	PDK
Vendimi Anr. 101	KDI	LDK
Vendimi Anr. 124	BIRN	PDK
Vendimi Anr. 125	BIRN	NISMA
Vendimi Anr. 126	BIRN	NISMA

Gjobat e Subjekteve Politike

Subjekti Politik	Shuma	Përqindja e gjobave sipas Subjekteve Politike
NISMA	5,500.00 €	50.46%
PDK	4,200.00 €	38.53%
LDK	1,200.00 €	11.01%
Totali	10,900.00 €	100.00%



PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT DHE PERSONELIT TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT, NË PUNËTORI DHE TRAJNIME TË NDRYSHME

Më qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale të personelit, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë, PZAP-i gjatë vitit 2016 ka organizuar dy punëtori në Durrës.

Punëtorja e organizuar nga data 24 mars 2016 deri me 27 mars 2016

Punëtorja ka qenë e planifikuar me Planin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2016, në të cilën punëtori janë diskutuar tema brenda përgjegjëseve të institucionit si në vijim: Prezantimi, shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së PZAP-it për vitin 2015, prezantimi dhe miratimi i Draft Planit të Punës për vitin 2016, shqyrtimi, diskutimi dhe miratimi i dokumentit të Planit Strategjik të PZAP-it 2016 – 2019, diskutimi lidhur me reformën zgjedhore, prezantimi i mënyrës së funksionimit të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Rasteve (SIMR), shqyrtimi, diskutimi i Draft Rregullores për Kodin e Mirësjelljes së Nëpunësve Civil të Sekretariatit të PZAP-it.

Ne punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesin, personeli i Sekretariatit të PZAP-it, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja si dhe nga IFES-i.

Kostoja e punëtorisë së mbajtur nga data 24 – 27 mars 2016 ka qenë në shume prej 7,736.00 euro.

Punëtorja e organizuar nga data 06 tetor 2016 deri me 09 tetor 2016

Edhe kjo punëtori ka qenë e planifikuar me Planin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2016, në të cilën punëtori janë diskutuar tema brenda përgjegjëseve të institucionit si në vijim: Prezantimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2017, prezantimi lidhur me ecurinë e punës së Grupit punues për përgatitjen e Buletinit të PZAP-it 2009 – 2014, janë prezantuar vendimet e zgjedhura për të gjitha fazat e procesit zgjedhor për periudhën 2009-2014 të cilat janë menduar që të përfshihen në buletin, shqyrtimi, diskutimi i Draft Rregullores për Kodin e Mirësjelljes së Nëpunësve Civil të Sekretariatit të PZAP-it, prezantimi, shqyrtimi dhe diskutimi i Raportit të punës së PZAP-it për periudhën janar – shtator 2016.

Gjate mbajtjes së punimeve të punëtorisë me datën 07 tetor 2016 në mbrëmje është organizuar ceremonia lamtumirëse me rastin e përfundimit të mandatit të kryesueses së PZAP-it znj. Nazmije Ibrahim. Në ceremoni kanë marrë pjesë të gjithë pjesëmarrësit e punëtorisë përfshirë këtu edhe Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës z. Fejzullah Hasani, i cili me këtë rast e ka falënderuar znj. Ibrahim për punën, angazhimin dhe kontributin e dhënë për PZAP-in dhe gjyqësorin në Kosove gjatë karrierës së saj. Në ceremoni znj. Ibrahim e kanë falënderuar edhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësorë të

Kosovës, z. Nehat Idrizi, në emër të PZAP-it ka përshëndetur dhe ka falënderuar anëtarin e PZAP-it si z. Ymër Hoxha dhe në emër të sekretariatit z. Mulë Desku, kryesues i Sekretariatit të PZAP-it. Me fjale rasti kësaj ceremonie i është drejtuar edhe znj. Ibrahimit e cila i falënderoj të gjithë të pranishmit për organizimin e ceremonisë dhe për bashkëpunimin që i kanë ofruar gjatë mandatit të saj në PZAP.

Në punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it përfshi kryesuesen, personeli i Sekretariatit të PZAP-it, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe përfaqësuesit nga OSBE-ja si dhe nga IFES-i.

Kostoja e punëtorisë së mbajtur nga data 06 – 09 tetor 2016 ka qene në shume prej 8,349.00 euro.

Gjatë periudhës kohore Shkurt – Prill 2016, disa anëtarë të PZAP-it dhe zyrtarë të Sekretariatit të PZAP-it, si pjese e Grupit punues kane marre pjesë në pesë punëtori të organizuara nga IFES-i, lidhur me përgatitjen dhe finalizimin e dokumentit të Planit Strategjik, për periudhën 2016 – 2019.

Ndërsa me datë 13.04.2016, anëtarët e PZAP-it miratuan planin strategjik duke i shqyrtuar të gjitha ndryshimet, plotësimet dhe rekomandimet e dhëna nga anëtarët e panelit dhe akteret e jashtëm.

Personeli i Sekretariatit dhe disa anëtarë të PZAP-it kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga IFES-PZAP me temën: Monitorimi dhe Vlerësimi, ku është diskutuar lidhur me monitorimin dhe vlerësimin, mënyrat së si bëhet monitorimi dhe vlerësimi i objektivave dhe aktiviteteve të Institucionit.

IFES ka organizuar dhe ka mbajtur intervista individuale me disa anëtarë të Panelit dhe të Sekretariatit të PZAP-it, lidhur me vlerësimin e nevojave për trajnimin e zyrtarëve të institucionit të PZAP-it.

Si rezultat i punës të Grupit Punues për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, IFES-i ka përgatitur Udhëzuesin për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuar në Proceset Zgjedhore dhe Politike, me këtë rast IFES-i ka bërë lansimin e këtij Udhëzuesi, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Sekretariatit të PZAP-it.

Punëtoritë e organizuara nga OSBE-ja për përkrahjen e PZAP-it

Nga data 30.05.2016 deri me 31.05.2016 OSBE ka organizuar punëtorinë me temën: Menaxhimi i Ciklit të Projekteve, ku pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin disa zyrtarë nga sekretariatet e PZAP-it dhe zyrtarë të sekretariatit të KQZ-së, dhe,

Me datën 20.07.2016 OSBE ka organizuar punëtorinë me organet gjyqësore për procedurat zgjedhore, ku pjesëmarrës kanë qenë përfaqësuesit e institucioneve të cilët janë akteret të procesit zgjedhor si: PZAP-i, KQZ, Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor, Policia e Kosovës, etj.

Në këtë punëtori nga PZAP-i kanë marrë pjesë anëtarët e Panelit si dhe përfaqësues të Sekretariatit të PZAP-it.

Po ashtu OSBE me datën 14.12.2016 ka organizuar punëtorinë lidhur me mësimet e nxënë, ku pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin anëtarët e PZAP-it dhe zyrtarët e sekretariatit të PZAP-it.

Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ishte vlerësimi i përgjithshëm i performancës së PZAP-it për vitin 2016 dhe prezantimi i pikave kryesore të Planit të Punës së PZAP-it për vitin 2017.

Punëtori e organizuar nga zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me reformën Kushtetuese dhe Zgjedhore.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të PZAP-it në punëtorinë e organizuar nga Zyra e Presidentit e mbajtur nga data 07 - 12 dhjetor 2016, në Durrës.

Qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë shqyrtimi dhe finalizimi i akteve në vijim:

- Propozim amendamenteve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me zgjedhjen e Presidentit dhe çështjet e ndërlidhura;
- Projektligji për zgjedhjet qendrore në Republikën e Kosovës.
- Projektligji për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Ne këtë punëtori përveç përfaqësuesve të institucioneve të emëruara me Vendimin Nr. 155/2016 të datës 16.11.2016 të Presidentit të Kosovës për Themelimin e Ekipeve punuese për hartimin e legjislacionit për reformën zgjedhore në Republikën e Kosovës nga PZAP-i kanë marr pjesë Kryesuesja e PZAP-it znj. Gyltene Sylejmani dhe anëtari i PZAP-it z. Hasan Shala. Përfaqësuesit e PZAP-it kanë paraqitur qëndrimet dhe rekomandimet e miratuara nga PZAP-i me qëllim të fuqizimit të institucionit me Ligjin për Zgjedhjet Qendrore në Republikën e Kosovës.

LANCIMI I PLANIT STRATEGJIK TË PZAP-it
2016-2019

LANCIMI I PLANIT STRATEGJIK TË PZAP-it 2016-2019

Në tetor të vitit 2015 PZAP-i ka filluar përgatitjen e Planit Strategjik për periudhën 2016-2019, ku lidhur me përgatitjen e kësaj strategjie ka formuar Grupin punues nga anëtarët e Panelit dhe zyrtarë të Sekretariatit të PZAP-it. Si rezultat i punës së vazhdueshme disa mujore, PZAP-i arriti që me datën 08 Qershor 2016 në Hotel Sirius në Prishtinë, ta organizoj dhe ta bëjë lansimin e këtij Plani Strategjik, ku pjesëmarrës në këtë lansim ishin të gjithë anëtarët dhe zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-it, drejtori i USAID-it, përfaqësuesit e OSBE-së, përfaqësuesit e IFES-it, Kryetarja e KQZ-së dhe Kryeshefi Ekzekutiv i sekretariatit të KQZ-së, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës (KGJK-së) përfaqësues të Gjykatës Supreme të Kosovës, të Policisë së Kosovës, përfaqësues të subjekteve politike, përfaqësues të OJQ-ve, të mediave etj.

Në takimin e lansimit janë elaboruar edhe shtyllat strategjike, synimet strategjike, objektivat strategjike dhe aktivitetet strategjike të Planit Strategjik të PZAP-it 2016 – 2019. Takimi për lansimin e Planit Strategjik të PZAP-it është mbështetur nga IFES-i.

GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E BULETINIT TË PZAP-it

Me qellim të hartimit të Buletinit të PZAP-it për periudhat zgjedhore nga zgjedhjet e vitit 2009 deri në vitin 2014, PZAP-i ka formuar Grupin Punues për hartimin e këtij dokumenti me datë 08 Korrik 2016. Grupi Punues ka mbajtur takim me datë 28 Korrik 2016, në të cilin është shqyrtuar dhe diskutuar lidhur me formën dhe përmbajtjen e Buletinit të PZAP-it, ku si përmbajtje do të ketë pjesën hyrëse, publikimi i vendimit në tërësi si dhe përzgjedhja e një numri të vendimeve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Grupi punues ka mbajtur takime të shpeshta me të cilën është arritur përzgjedhja e vendimeve dhe përgatitja e para hyrjeve sipas propozimit të kryesuesit të Grupit me të cilën propozim janë pajtuar anëtarët e PZAP-it. Këto vendime të përzgjedhura janë inkorporuar në Draftin e buletinit dhe pas miratimit nga paneli i PZAP-it do të finalizohet.

Lidhur me ecurinë e punës, kryesuesi dhe anëtarët e Grupit Punues kanë raportuar në çdo takim të rregullt të PZAP-it.

Ne punëtorinë e PZAP-it e cila është mbajtur me datën 14 dhjetor 2016, të cilën punëtori e ka organizuar dhe mbështetur OSBE-ja, është rekomanduar që në dokumentin e buletinit të përfshihen

edhe vendimet e PZAP-it për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të vitit 2016.

Sipas rekomandimit nga kjo punëtori Grupi punues i PZAP-it ka përzgjedhur disa vendime nga ky proces zgjedhor të cilat i ka përfshi në Draft Buletin.

Drafti i buletinit është në fazën e finalizimit dhe pritet që të miratohet në pjesën e parë të vitit 2017.

PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT DHE PERSONELIT TË SEKRETARIATIT NË VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË DISA VENDE TË RAJONIT

Vizita në Republikën e Kroacisë nga data 10 – 13 shtator 2016

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave reciproke me institucionet që merren me zgjedhje, përfitimit dhe avancimit të njohurive mbi praktikën e mirë të zgjedhjeve, PZAP-i nga data 10 shtator 2016 deri me 13 shtator 2016 ka realizuar një vizitë studimore për të vëzhguar Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Parlamentare në Republikën e Kroacisë.

Ambasada e Republikës së Kosovës në Zagreb, me përkrahjen e diplomatit të kësaj ambasade z. Amir Haziri, ka organizuar vizitën studimore dhe për vëzhgimin e zgjedhjeve të delegacionit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) të Republikës së Kosovës, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Parlamentare të mbajtura me 11 shtator 2016 në Republikën e Kroacisë. Delegacioni i PZAP-it është përberë nga: Kryesuesja e PZAP-it Znj. Nazmije Ibrahim, Kryesues i Sekretariatit të PZAP-it z. Mulë Desku, Anëtarët e PZAP-it: z. Rafet Haxhaj, z. Adnan Konushevci, z. Fejzullah Rexhepi, z. Faton Ademi dhe znj. Afijete Sada, si dhe zyrtari i transportit z. Xhevdet Millaku.

Gjatë kësaj vizite 4 ditore është vëzhguar procesi zgjedhor në disa vendvotime si dhe janë realizuar disa takime të rëndësishme me autoritetet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ-së) të Republikës së Kroacisë dhe të autoriteteve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë.

Delegacioni i Kosovës është pritur në takime nga Kryetari i KSHZ-se z. Branko Hrvatin, Nën kryetari i KSHZ-se Z. Jakob Miletić dhe anëtarët tjerë të KSHZ-së së Kroacisë. Takimi i delegacionit të Republikës së Kosovës me autoritetet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Kroacisë është realizuar një ditë pas ditës së zgjedhjeve, pra të hënë me 12 shtator 2016. Takimi është realizuar në frymë miqësore dhe profesionale ku palët bashkëbiseduese janë njoftuar me funksionet dhe përgjegjësitë e KSHZ-së së Kroacisë dhe të PZAP-it të Republikës së Kosovës, dhe nga kryetari z.

Hrvatini me stafin e tij, delegacionit të Kosovës ju është shpjeguar ecuria e zgjedhjeve dhe është përgjigjur në pyetjet e delegacionit të PZAP-it në lidhje me procesin zgjedhorë të mbajtur me datën 11 shtator 2016.

Takimi mjaftë i rëndësishme ishte edhe ai i organizuar me autoritetet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë. Delegacionin e Republikës së Kosovës në selinë e Gjykatës e ka pritur Nënkyetarja e Gjykatës Kushtetuese znj. Snjezana Bagic dhe Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese po ashtu ditën e hënë me 12 shtator 2016. Nënkyetarja e Gjykatës Kushtetuese znj. Snjezana Bagic dhe Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese pa hezitim u janë përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të parashtruara nga anëtarët e delegacionit të Kosovës rreth mandatit dhe procedurave të kësaj gjykate në vendosjen e ankesave lidhur me procesin zgjedhor, organizimit të punës së tyre dhe ju janë shpalosur shume përvoja të këtij institucioni përgjatë procesit zgjedhorë të 11 shtatorit 2016 dhe praktika të proceseve të mëhershme zgjedhore.

Delegacioni i PZAP-it i Republikës së Kosovës është ndarë shume i kënaqur me praktikat e mira që i ka vërejtur nga afër gjatë ditës së zgjedhjeve në Qendrat e Votimit, shkëmbimi i përvojave profesionale dhe diskutimet që kemi pasur në takimet me përfaqësuesit e larte të institucioneve të theksuara më lartë dhe këto përvoja dhe praktika do të jenë shume të mirëseardhura për PZAP-in.

Delegacioni i PZAP-it i Republikës së Kosovës përmes email-it me një letër i ka shprehur mirënjohjen e tij dhe ka falënderuar autoritetet e Komisionit Shtetërorë të Republikës së Kroacisë për përkrahjen që KSHZ-ja i ka ofruar delegacionit para, gjatë dhe pas procesit zgjedhorë në realizimin e kësaj vizite të cilën e konsideron si shumë të dobishme në kuptim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të institucionit të PZAP-it.

Me datën 13 shtator 2016 delegacioni ka vizituar Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën e Kroacisë ku është pritur nga diplomati i kësaj Ambasade Z. Amir Haziri dhe disa diplomat tjerë të Ambasadës.

Kostoja financiare e vizitës së delegacionit të PZAP-it në Republikën e Kroacisë ka qenë në shume prej 5,915.00 euro.



Figura 1- Takim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve në Republikën e Kroacisë



Figura 2- Takim në gjykatën kushtetuese të Republikës së Kroacisë

Vizita në Republikën e Malit të Zi nga data 14 – 17 tetor 2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) ka marrë pjesë në vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Malit të Zi, të cilat janë mbajtur me datën 16 Tetor 2016. Vizita është realizuar nga data 14 deri me datën 17 tetor 2016.

Ambasada e Republikës së Kosovës në Mal të Zi, me përkrahjen e Ambasadorit të kësaj ambasade z. Skender Durmishi, ka lehtësuar organizimin e vizitës studimore dhe për vëzhgimin e zgjedhjeve të delegacionit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) të Republikës së Kosovës për Zgjedhjet Parlamentare të mbajtura me 16 tetor 2016 në Mal të Zi. Realizimin e kësaj vizite e ka lehtësua dhe ndihmuar edhe Këshilltari nacional i Zgjedhjeve në Misionin e OSBE-së në Kosovë z. Bujar Basha, i cili përkohësisht ka qenë i angazhuar me misionin në Republikën e Malit të Zi. Përbërja e delegacionit të PZAP-it ishte si në vijim: Znj. Nazmije Ibrahim, Kryesuese e PZAP-it, Z. Mulë Desku, Kryesues i Sekretariatit të PZAP-it, anëtarët e PZAP-it: Z. Hasan Shala, Z. Nenad Lazic dhe Z. Adnan Konushevci, si dhe Znj. Nexhmije Zogaj – Simnica, Zyrtare Kryesore Financiare dhe Z. Xhevdet Millaku, zyrtar i transportit.

Gjatë kësaj vizite 4 ditore është vëzhguar procesi zgjedhorë në disa vendvotime si dhe është realizuar një takim me kryetarin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Malit të Zi.

Kryesuesja e PZAP-it Znj. Nazmije Ibrahim me Kryesuesen e KQZ-se znj. Valdete Daka bashkë me Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Mal të Zi, Z. Skender Durmishi, kanë zhvilluar një takim me Kryetarin e KSHZ-së Malit të Zi, Z. Budimir Sharanovic. Takimi është realizuar me datën 15 tetor 2016.

Takimi është mbajtur në frymë miqësore dhe profesionale ku palët bashkëbiseduese janë njoftuar me funksionet dhe përgjegjësitë e KSHZ-së së Malit të Zi, të PZAP-it dhe të KQZ-së.

Po ashtu ditën e shtunë me datën 15 tetor 2016, delegacioni i PZAP-it dhe ai i KQZ-së kanë vizituar Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mal të Zi. Dy delegacionet janë pritur nga Ambasadori Z. Skender Durmishi me stafin e Ambasadës. Në takim, Ambasadori Z. Durmishi njoftoj delegacionin me punën e Ambasadës si dhe me rendësinë e vizitës së delegacionit për të vëzhguar Zgjedhjet Parlamentare të Malit të Zi.

Me datën 16 tetor 2016 gjatë ditës së votimit, delegacioni ka vizituar disa Qendra të Votimit në Komunën e Ulqinit dhe në Komunën e Tuzit.

Delegacioni i PZAP-it i Republikës së Kosovës është ndarë i kënaqur me praktikën e mira që i ka vërejtur nga afër gjatë ditës së zgjedhjeve në Qendrat e Votimit, informatat dhe shkëmbimi i

informatave, me trupat menaxhuese të zgjedhjeve në Vendvotime si dhe shkëmbimi i përvojave profesionale dhe diskutimet që Kryesuesja e PZAP-it bashkë me Kryesuesen e KQZ-së dhe Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Mal të Zi kanë pasur me Kryetarin e Komisionit Shtetëror të Malit të Zi, Z. Branimir Sharanovic.

Këto përvoja dhe praktika të nxëna gjatë procesit zgjedhor në Mal të Zi do të jenë shumë të mirëseardhura për PZAP-in.

Delegacioni i PZAP-it i Republikës së Kosovës përmes email-it ka dërguar një letër Ambasadorit të Republikës së Kosovës, të cilit i ka propozuar që të dërgoj një letër falënderimi dhe për të shprehur mirënjohje Komisionit Shtetërorë të Malit të Zi për përkrahjen që KSHZ-ja i ka ofruar delegacionit për të mundësuar vëzhgimin e procesit zgjedhor në Mal të Zi dhe këtë vizite e konsideron si shumë të dobishme në kuptim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të institucionit të PZAP-it.

Kostoja financiare e vizitës së delegacionit të PZAP-it në Republikën e Malit të Zi ka qenë në shumë prej 3,164.00 euro.

Vizita në Republikën e Maqedonisë nga data 09 – 12 dhjetor 2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka marr pjesë në vëzhgimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme Parlamentare në Republikën e Maqedonisë, të cilat janë mbajtur me datën 11 dhjetor 2016. Vizita është realizuar nga data 09 dhjetor 2016 deri me datën 12 dhjetor 2016.

Delegacioni i PZAP-it ishte i përberë nga anëtarët e PZAP-it: z. Ymer Hoxha, z. Zyhdi Haziri, z. Rafet Haxhaj, z. Fejzullah Rexhepi, z. Faton Ademi dhe znj. Afijete Sada, Kryesues i Sekretariatit të PZAP-it, z. Mulë Desku, Zyrtari i Lartë Ligjor z. Kudret Hasani si dhe zyrtari i transportit z. Xhevdet Millaku.

Me datën 10 dhjetor ditë e Shtunë, delegacioni i PZAP-it vizitoi Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) të Maqedonisë ku u pritën në zyrën e anëtarit të komisioni z. Subhi Jakupi, ku prezent ishin edhe nënkryetari i komisionit z. Rexhep Prekopuca, dhe anëtari i komisionit z. Bedredin Ibrahimimi me bashkëpunëtorë të tjerë.

Anëtari i KSHZ-së z. Jakupi së pari i uroi mirëseardhje delegacionit të PZAP-it, duke i njoftuar më pastaj me përbërjen e KSHZ-së, me rolin e tij, me mënyrën edhe procedurat rreth funksionimit të tij, si dhe me gjitha përgatitjet që ishin bërë për zgjedhjet e 11 dhjetorit 2016 si dhe me mangësi dhe defektet tjera të cilat e kishin përcjellë këtë proces zgjedhor. Z. Jakupi njoftoi me rolin e KSHZ-së lidhur me ankesat e ndryshme që paraqiten në këtë institucion, me afatet për vendosjen e tyre si dhe me organet tjera kompetente që vendosin për parregullsitë e paraqitura gjatë procesit zgjedhor.

Gjatë kësaj vizite delegacioni i PZAP-it bashke me delegacionin e KQZ-së së Republikës së Kosovës mori pjesë në konferencën e organizuar nga KSHZ-ja ku pjesëmarrës në këtë konferencë ishin edhe delegacione tjera nga shtete të ndryshme të Evropës si nga Republika e Kroacisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Malit të Z etj., të cilët ishin të akredituar për vëzhgimin e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë.

Në këtë konference prezantuan kryetari dhe anëtarët e KSHZ-së të Republikës së Maqedonisë të cilët i njoftuan të pranishmit me të gjithë përgatitjet e bëra për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme Parlamentare të 11 dhjetorit 2016.

Në mbrëmje e datës 10 dhjetor 2016, delegacioni i PZAP-it mori pjesë në darkën solemne të organizuar nga KSHZ-ja e Republikës së Maqedonisë ku pjesëmarrëse në këtë darkë solemne ishin edhe përfaqësuesit e delegacioneve të ndryshme Evropiane të cilët kishin ardhur për të vëzhguar këto zgjedhje.

Me datën 11 dhjetor 2016, gjatës ditës së zgjedhjeve, delegacioni i PZAP-it monitoroi nga afër disa Qendra të Votimit fillimisht në qytetin e Shkupit, qytetin e Tetovës dhe atë të Strugës.

Zyrtarët e PZAP-it gjatë vëzhgimit të këtyre vendvotimeve u njoftuan nga afër me mbarëvajtjen dhe procedurat e votimit, rreth numrit të përgjithshëm të votuesve për ato vendvotime si dhe me numrin e pjesëmarrjes së votuesve për votim deri në ato momente.

Në mbrëmje me të përfunduar procesi i votimit, Kryesuesi dhe zyrtari i lartë ligjor i Sekretariatit të PZAP-it vizituan përsëri ambientet e KSHZ-së ku pritej të mbahej press konferenca e KSHZ-së lidhur me kumtimin dhe publikimin e rezultateve zgjedhore.

Gjatë kësaj kohe zyrtarët e SPZAP-it vizituan edhe personelin e administratës së KSHZ-së nga të cilët u njoftuan për së afërmi me punën e tyre si dhe u njoftuan rreth parregullsive të paraqitura gjatë ditës së votimit.

Delegacioni i PZAP-it është ndarë shumë i kënaqur me përvojat dhe praktikat e mira të fituara nga vëzhgimi i zgjedhjeve dhe nga takimet e realizuara me zyrtarët e KSHZ-së.

Kjo vizitë e realizuar kishte për qëllim ngritjen profesionale të institucionit si dhe përfitimin e njohurive dhe shkëmbimin e përvojave në mes të PZAP-it dhe institucioneve të Republikës së Maqedonisë të cilat merren me organizimin e zgjedhjeve.

Kostoja financiare e vizitës së delegacionit të PZAP-it në Republikën e Maqedonisë ka qenë në shume prej 3,329.00 euro.

Me datën 13 tetor 2016, një delegacioni i Departamentit Ligjor të Komisionit Shtetëror të Maqedonisë ka vizituar PZAP-in.

Delegacioni i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë, i përbërë nga katër këshilltarë ligjorë të këtij institucioni si dhe nga përfaqësuesi i OSBE-së misioni në Maqedoni, kanë realizuan vizitë një ditore në PZAP.

Ata janë pritë në takim nga Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it si dhe nga Zyrtarët Ligjor të Sekretariatit. Vizita kishte karakter njoftues në mes të këtyre dy institucioneve, ku u shkëmbyen përvoja ndër institucionale rreth proceseve zgjedhore, ku me theks të veçantë si tema të interesit ishin njoftimi për së afërmi me organizimin dhe funksionimin e PZAP-it, me procesin ankimor, me llojin dhe natyrat e ankesave të paraqitura, parregullsitë më të shpeshta të cilat paraqiten në PZAP etj.

Mysafirët u njoftuan me sfidat në përgjithësi me të cilat ballafaqohet institucioni i PZAP-it gjatë një procesi zgjedhor në veçanti, për afatet e shkurtra për shqyrtimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve.

BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME KOMISIONIN QENDROR ZGJEDHOR -(KQZ)

Bashkëpunimi i PZAP-it dhe i KQZ-së, është i bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës (LZP). Ky bashkëpunim është i përhershëm i nevojshëm dhe i detyrueshëm para, gjatë dhe pas proceseve zgjedhore ngase ashtu edhe përcaktohet me LZP.

Gjatë kësaj periudhe PZAP-i dhe KQZ-ja kanë pasur bashkëpunim lidhur me kërkesat për verifikimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), verifikimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), verifikimin e Menaxherëve të Qendrave të Votimit (MQV) se a janë të dënuar me vendim të PZAP-it në zgjedhjet e kaluara.

Kërkesat e PZAP-it për përgjigje në ankesë/apel ndaj vendimeve të KQZ-së, të cilat vendime palët i kanë ankimuar në PZAP, kërkesat e PZAP-it adresuar KQZ-së për ti ofruar mundësinë e hetimit të materialit zgjedhor në Qendrat e Votimit (QV) sipas pretendimeve ankimore të parashtruesit të ankesës. PZAP-i e ka njoftuar KQZ-në, për përfundimin e procesit ankimor dhe vendosjen e të gjitha ankesave nga PZAP-i, dhe pas këtij konfirmimi nga PZAP-i, KQZ-ja ka certifikuar rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogoc të mbajtur më 04.12.2016 dhe Raundit të dytë të mbajtur me datën 18.12.2016.

Po ashtu PZAP-i ka njoftuar KQZ-në për gjobat e paguara dhe të papaguara nga subjektet politike për zgjedhjet paraprake, gjë e cila i ka mundësuar KQZ-së certifikimin e subjekteve politike për të garuar në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogoc.

PZAP-i ka njoftuar KQZ-në për personat të cilët janë ndaluar me vendim të PZAP-it, të cilëve iu është ndaluar e drejta që të jenë pjesë e stafit administrativ në zgjedhje për periudhën kohore të caktuar.

PZAP-i ka bashkëpunuar dhe komunikuar me ZRPPC-në për informatat e nevojshme për sigurimin e adresave të sakta të përfaqësuesve të subjekteve politike lidhur me zbatimin e procedurës së Përmbarrimit të vendimeve të PZAP-it për përmbarrimin e gjobave të papaguara të subjekteve politike prej vitit 2009-2014, të dhënat e subjekteve politike të regjistruara lidhur me rastet që janë në procedurë përmbarrimore.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të KQZ-së, ka rezultuar me një bashkëpunim të ngushtë nga fillimi e deri në përfundim të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc për të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

BASHKËPUNIM ME ORGANIZATËN PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM EUROPIAN – OSBE

Me zyrtarët e Departamentit të Zgjedhjeve të OSBE-së në vazhdimësi kemi pasur takime të herë pas herëshme pune dhe kemi diskutuar për çështje me interes që janë brenda përgjegjësi dhe mandatit të PZAP-it, në veçanti për komentet e Planit Strategjik të PZAP-it si dhe lidhur me trajnimet që na ka ofruar për vitin 2016.

Ashtu si çdo herë, OSBE-ja me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve, i ka ofruar përkrahje PZAP-it, në aspektin këshillues profesional, në organizimin e punëtorive për anëtarët e PZAP-it dhe stafin e sekretariatit.

Më datën 30-31 Maj 2016, OSBE ka organizuar trajnimin me temën: Menaxhimi i Ciklit të Projekteve, ku pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin disa zyrtarë nga sekretariatet e PZAP-it dhe të KQZ-së. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte fitimi i njohurive dhe përvojave rreth mënyrës së identifikimit të projekteve, menaxhimit të tyre, dizajnimin, monitorimin dhe vlerësimin e këtyre projekteve.

Me datën 20 Korrik 2016, OSBE ka organizuar punëtorinë me temën, “Procedurat Zgjedhore”, ku pjesëmarrës të kësaj punëtorie kanë qenë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve që jenë akteret të jashtëm dhe të brendshëm të zgjedhjeve si: PZAP-i, KQZ, Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor, Policia e Kosovës, etj. Në këtë rast nga PZAP-i kanë marrë pjesë anëtarët e Panelit si dhe përfaqësues të Sekretariatit të PZAP-it.

Me datën 14 dhjetor 2016 OSBE-ja ka organizuar punëtori me Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), lidhur me mësimet e nxënë. Organizimi i kësaj punëtorie nga OSBE-ja ka pasur për qëllim ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve dhe stafit të sekretariatit, ku temat e diskutimit kanë qenë Vlerësimi i përgjithshëm për performancën e PZAP-it në vitin 2016, Vlerësimi i çështjeve tematike (Plani strategjik; implementimi i planit të punës për vitin 2016; Buletini i PZAP-it; Sistemi i menaxhimit të lëndëve), Çështjet e personelit dhe buxhetit, shpalosja e pikave kryesore të Planit të punës për vitin 2017, përfshirë përgatitjen për zgjedhjet lokale të vitit 2017.

BASHKËPUNIM ME FONDIN NDËRKOMBËTAR PËR SISTEME ZGJEDHORE - IFES

IFES-i gjatë kësaj kohe në vazhdimësi i ka ofruar përkrahje PZAP-it në përgatitjen dhe finalizimin e dokumentit të Planifikimit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016–2019. Për hartimin e këtij dokumenti janë mbajtur disa punëtori ku pjesëmarrës ishin grupi punues i emëruar me vendim të PZAP-it. Po ashtu IFES ka ndihmuar PZAP-in në projektet rreth përgatitjes teknike në dizajnimin e dokumentit të Planit Strategjik të PZAP-it 2016 - 2019.

PZAP-i në bashkëpunim me IFES-in ka organizuar takimin lidhur me lansimin e Planit Strategjik të PZAP-it 2016 – 2019, i cili takim është mbajtur më datë 08.06.2016, ku pjesëmarrës kanë qenë përfaqësues nga USAID-i, përfaqësues nga KQZ-ja, përfaqësues nga radhët e OJQ-ve, përfaqësues të disa subjekteve politike si dhe përfaqësues të mediave.

Me qëllim të mbështetjes dhe asistencës teknike, USAID/IFES, i kanë propozuar PZAP-it programin e aktiviteteve për periudhën 30 mujore Gusht 2016 – Shkurt 2019, si dhe kanë ofruar Propozim Dokumentin lidhur me Vlerësimin e Nevojave të Trajnimit për PZAP-in.

IFES më datë 07.04.2016 ka organizuar trajnimin e radhës me temën: Monitorim dhe vlerësim me zyrtarët e SPZAP-it si dhe me disa anëtarë të PZAP-it.

Gjatë muajit maj 2016, IFES-i ka organizuar dhe mbajtur intervista individuale me disa anëtarë të PZAP-it dhe me zyrtarë të Sekretariatit të PZAP-it, lidhur me vlerësimin e nevojave për trajnimin e zyrtarëve të institucionit të PZAP-it.

MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT

Me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm institucional, lidhur me proceset zgjedhore me datë 2 Shkurt 2016, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të institucioneve të cilat merren me administrimin e zgjedhjeve dhe shqyrtimin e rasteve zgjedhore, si PZAP, KQZ, Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe Këshillit Gjyqësorë të Kosovës. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim të koordinojë veprimet ndër institucionale për të zgjidhur rastet e lidhura me zgjedhje në mënyre efikase dhe transparente.

REKOMANDIMET E MISIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE NE KOSOVE DHE ADRESIMI I TYRE NGA PZAP-I

Rekomandimet për Zgjedhjet Komunale ne Kosovë 3 nëntor dhe 1 dhjetor 2013

Nr.	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi	Statusi
1	T'i mundësohet ankuesit kohë e mjaftueshme për të përgatitur ankesën dhe për të dorëzuar provat, dhe PZAP-i për të shqyrtuar provat para nxjerrjes së vendimit.	Të zgjatet periudha për parashtrim të ankesës në 48 orë dhe periudha për PZAP-in për të vendosur në 4 ditë.	Të ndryshohet LZP.	Kuvendi i Kosovës.	Të drejta për mjete efektive juridike; KEDNJ neni 13; KNDCP neni 2; DUDNJ, neni 8.	PZAP-i Grupit Punues për Reforme Zgjedhore ne vitin 2012 i ka propozuar Zgjatjen e afatit për parashtrim te ankesës prej 24 ore ne 48 ore. Ndërsa për te vendosur lidhur me ankesën PZAP-i ka propozuar që afati prej 72 orëve te zgjatet ne 96 ore. Me propozimin e fundit për reformë zgjedhore afati për parashtrim te ankesës ka mbetur ashtu siç është tani me LZP 24 ore. Ndërsa 72 ore për te vendosur PZAP-i lidhur me ankesën. Reforma ka mbetur pa përfunduar.
2	T'i jepet mundësia ankuesit që të dorëzojë prova, si dhe të prezantojë rastin.	Të garantohet e drejta për dëgjim të ankesave.	Të ndryshohet LZP.	Kuvendi i Kosovës, PZAP.	E drejta për gjykim të drejtë; KEDNJ, neni 6; KNDCP, neni 14.	PZAP-i ne zgjedhjet e kaluara ka mbajtur disa seanca dëgjimore. PZAP-i Ne zgjedhjet e ardhshme do te organizoj edhe mbaje me shume seanca dëgjimore nëse konsiderohet e nevojshme.
3	Të shtohet efikasiteti i	Të përforcohen	T'i sigurohet	Kuvendi i	E drejta për	PZAP-it i ka buxhet te mjaftueshëm për

	gjithmbarshëm i sistemit për trajtim të kontesteve zgjedhore.	kapacitetet e Sekretariatit të PZAP-it me qëllim të përmirësimit të punës ligjore të PZAP-it në përgatitjen e vendimeve.	PZAP-it më shumë buxhet; Zyrtarët ligjor të PZAP-it të trajnohen; Të krijohet baza e të dhënave të zyrtarëve ligjor.	Kosovës; Sekretariati i PZAP-it.	gjykim të drejtë; KNDKP, neni 14; DUDNJ, neni 10; KEDNJ, neni 6.	kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij. Zyrtaret ligjore vazhdimisht janë trajnuar: Ne vitin 2017 janë planifikuar 12 trajnime me tema të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve. Ne vitet 2015 dhe 2016 janë organizuar trajnime të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të zyrtareve ligjor Ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtareve ligjor do ta ketë efektin pozitiv në kryerjen e punëve të tyre në zgjedhjet e ardhshme. Me përkrahjen e IFES-it USAID-it, PZAP ka krijuar bazën e të dhënave elektronike për regjistrimin e ankesave dhe Parashtresave, respektivisht Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Rasteve (SEMR)
4	Të shtohet transparenca e procesit të ankesave dhe parashtresave.	PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të publikojnë ankesat dhe parashtresat, si dhe vendimet, në të gjitha gjuhët zyrtare, në faqet e tyre në internet, dhe me kohë.	Të ndryshohet Ligji për gjykatat.	Kuvendi i Kosovës, PZAP dhe Gjykata Supreme.	Transparenca.	Me krijimin SEMR të PZAP-it kjo çështje është adresuar. Palët tani kanë qasje lidhur me ankesën e parashtruar prej dorëzimit e deri në marrjen e vendimit nga PZAP-i . www.pzap-ks.org Kjo çështje është adresuar që nga vit 2012 PZAP-i Vendimet e tij çdo herë i ka publikuar me kohë në Ueb Faqen Zyrtare të PZAP-it në përputhje me Ligjin për

						Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.
5	Procesi i ankesave rreth shkeljeve zgjedhore t'i afrohet votuesve dhe të zbuten pengesat në kapacitetin e PZAP-it.	(a) Të bëhet PZAP pjesë e Gjyqësorit të Kosovës; (b) Të shqyrtohet mundësia e decentralizimit të procesit të ankesave, ashtu që t'i jepet përgjegjësia Gjykatave Themelore që të vendosin në shkallë të parë, kurse PZAP të jetë organ apeli.	Të ndryshohet Ligji për gjykatat; Të ndryshohet LZP.	Kuvendi i Kosovës.	Të drejtat për mjete efektive juridike; KEDNJ neni 13; KNDKP neni 2; DUDNJ, neni 8.	Kjo çështje nuk është ne kompetence të PZAP-it. PZAP-i mund të jep rekomandime autoriteteve vendimmarrëse të Kosovës si : Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ekspertizën e deritanishme të PZAP-it, përpirësit dhe vështirësitë e funksionimit të institucionit e jo të merre vendime për statusin ligjor të tij.

REKOMANDIMET E PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE, 8 QERSHOR 2014

Nr .	Qëllimi	Rekomandimi	Aktivitetet e sugjeruara	Institucionet e synuara	Parimi	Statusi
1	T'i jepet ankuesit zgjedhor kohë e mjaftueshme për të përgatitur ankesën dhe paraqitur dëshmitë.	Zgjatja e periudhës për paraqitje të ankesës në 48 orë pas zgjedhjeve.	Ndryshimi i LPZ-së.	Kuvendi i Kosovës.	E drejta në mjet efektiv juridik; KEDNJ neni 13; ICCPR. Art 2; DUDNJ, neni 8.	PZAP-i Grupit Punues për Reforme Zgjedhore ne vitin 2012 i ka propozuar Zgjatjen e afatit për parashtrim te ankesës prej 24 ore ne 48 ore. Ndërsa për te vendosur lidhur me ankesën PZAP-i ka propozuar që afati prej 72 orëve te zgjatet ne 96 ore. Me propozimin e fundit për reformë zgjedhore afati për parashtrim te ankesës ka mbetur ashtu siç është tani me LZP 24 ore. Ndërsa 72 ore për te vendosur PZAP-i lidhur me ankesën. Reforma ka mbetur pa përfunduar.
2	Të sigurohet se të gjitha ankesat janë hetuar si duhet.	Mbajtja e seancave dëgjimore dhe hulumtimi proaktiv për prova, të bëhet rregull e jo përjashtim.	Ndryshimi i LPZ-së dhe rregulloren e brendshme të punës së PZAP-it.	Kuvendi i Kosovës, PZAP.	Transparenca; E drejta për seancë dëgjimore; CGPEM (VC), 3.3. h).	PZAP-i ka mbajtur disa seanca dëgjimore kur e ka konsideruar te nevojshme dhe ka pasur rol proaktiv ne hulumtimin e provave për rastet te cilat i ka hetuar ne zgjedhjet e kaluara. Po ashtu PZAP-i ka plotësuar dhe ka amandametuar Rregullën Nr. 02/2015 për Procedurat e PZAP-it dhe ka miratuar Rregullën Nr. 04/2015 Për Procedurat e

						hetimit te materialit zgjedhor
3	Të rritet transparenca e procesit të parashtresave dhe ankesave.	PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të publikojnë me kohë parashtresat, ankesat, dhe vendimet në të gjitha gjuhët zyrtare në faqen e saj të internetit.	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatat.	Kuvendi i Kosovës, PZAP dhe Gjykata Supreme.	Transparenca.	Me krijimin SEMR te PZAP-it kjo çështje është adresuar. Palët tani kane qasje lidhur me ankesën e parashtruar prej dorëzimit e deri ne marrjen e vendimit nga PZAP-i . www.pzap-ks.org Kjo çështje është adresuar qe nga viti 2012. PZAP-i Vendimet e tij çdo here i ka publikuar me kohe ne Ueb Faqen Zyrtare te PZAP-it ne përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.
4	Procesi i ankimimit për shkeljet zgjedhore të sillet më afër votuesve dhe të lehtësohen kufizimet në kapacitetet e PZAP- it.	Mund të merret parasysh decentralizimi i procesit të ankimimit, duke e bërë zyrën kryesore të PZAP-it organ i apelit.	Mund të merret parasysh decentralizimi i procesit të ankimimit, duke e bërë zyrën kryesore të PZAP-it organ i apelit.	Kuvendi i Kosovës.	E drejta në mjet efektiv juridik; KEDNJ neni 13; ICCPR. Neni 2; DUDNJ, neni 8.	Kjo çështje nuk është ne kompetence te PZAP-it. PZAP-i mund te jep rekomandime autoriteteve vendimmarrëse te Kosovës si : Kuvendit te Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor te Kosovës për ekspertizën e deritanishme te PZAP-it, përpirësit dhe vështirësitë e funksionimit te institucionit e jo te merre vendime për statusin ligjor te tij.

PËRFUNDIME

Nga raportimi vjetor i punës së PZAP-it rezulton së janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit dhe fuqizimit të funksionimit të institucionit të PZAP-it, po ashtu edhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me akteret e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit.

Gjithashtu kemi pasur një rritje të bashkëpunimit me disa institucione të vendeve të rajonit që merren me organizimin e zgjedhjeve dhe me mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

Është vepruar me efikasitet në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përputhshmëri me ligj dhe brenda afateve kohore për procesin zgjedhor të Jashtëzakonshëm për Kryetar të Komunës në Glllogoc, ku palët e ankuara në procedurë me kohe janë njoftuar me vendime, dhe vendimet e tyre janë publikuar në Web faqen e PZAP-it.

Me synim rritjen e perceptimit të publikut për një institucion me afër atyre që i adresojnë ankesat dhe parashtrësat, i hapur dhe transparent, i cili ofron informacione të nevojshme mbi rolin dhe veprimtarinë e tij, PZAP-i ka kryer një numër të caktuar të aktiviteteve dhe ka marrë vendime brenda përgjegjësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2016 vëmendje e veçante i është kushtuar zhvillimit dhe forcimit të me mëtejme të kapaciteteve profesionale në përgatitjen e dokumenteve të rëndësishme të institucionit, përgatitjen e vendimeve, përgatitjen e rregulloreve, përgatitjen për proceset e ardhshme zgjedhore, pjesëmarrja e anëtarëve të PZAP-it dhe zyrtareve të sekretariatit në trajnime dhe punëtori etj.

Bazuar në të gjitha sa është paraqitur në raport, rezulton se:

Si hap i rëndësishëm vlerësohet përballimi me sukses i procesit të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Glllogocit të mbajtura me datën 04.12.2016 dhe raundit të dytë të mbajtur me datën 18.12.2016.

Funksionalizimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Rasteve (ankesave dhe apeleve), respektivisht përdorimi i këtij sistemi nga ana e zyrtareve të Sekretariatit është një tregues së ky sistem do të ndihmon dhe lehtëson punën e tyre dhe do të ndikon në rritjen e performancës së PZAP-it në të ardhmen. Krijimi i këtij sistemi ka qene rekomandim i Misionit Vëzhgues të BE për Zgjedhjet Komunale të vitit 2013 dhe Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2014 dhe i cili tani konsiderohet i adresuar.

Hap i rëndësishëm është Përgatitja dhe miratimi i Planit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019 i cili është një udhërrëfyes mjaft i rëndësishëm për përgatitjen e objektivave dhe aktiviteteve me Planet vjetore të punës së PZAP-it, me realizimin e të cilave do të fuqizohet institucioni i PZAP-it.

Si e rëndësishme vlerësohet edhe përgatitja e draft buletinit të PZAP-it për periudhën 2009 – 2016, i cili dokument do të ndihmoj anëtarët dhe zyrtaret e Sekretariatit për përdorimin e praktikave të mira në marrjen e vendimeve në proceset e ardhshme zgjedhore,

Vizitat e realizuara të anëtarëve të PZAP-it dhe zyrtareve të Sekretariatit për vëzhgimin e zgjedhjeve në disa shtete si në Republikën e Kroacisë, në Republikën e Malit të Zi dhe në Republikën e Maqedonisë konsiderohen dhe vlerësohen si hapa të rëndësishëm në kuptim të ngritjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit me institucionet respektive të këtyre shteteve, ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve si dhe përfitimit të praktikave të mira ndërkombëtare për zgjedhje.

Miratimi i Rregullores për Kodin e Mirësjelljes së Shërbyesve Civil të sekretariatit të PZAP-i vlerësohet si hap i rëndësishëm në kuptim të zbatimit të kodit të mirësjelljes nga ana e nëpunësve civil dhe mirësjelljes së tyre në përputhje me këtë kod.

SFIDAT

Mungesa e hapësirave të nevojshme për anëtarët e PZAP-it dhe zyrtaret e Sekretariatit, për kryerjen e punëve dhe zhvillimin veprimtarisë së tyre është një sfidë që po na përcjellë dhe nuk kemi gjasa që të zgjidhim këtë çështje. Kemi kërkuar ndihmën e Ministrisë së Administratës Publike, por ende nuk kemi ndonjë zgjidhje të kësaj çështje. Mungesa e hapësirave do të vështirësoj zhvillimin e veprimtarisë së PZAP-it në të ardhmen, në veçanti për mbajtjen e seancave dëgjimore gjatë Zgjedhjeve Komunale të vitit 2017 dhe Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2018.

Pamundësia për të rekrutuar Drejtorin e Departamentit Ligjorë ka qenë një sfidë tjetër e Sekretariatit të PZAP-it. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për rekrutimin e drejtorit përmes shpalljes së konkurseve të brendshme dhe të jashtme, duke i zbatuar Procedurat e Ligjit të Shërbimit Civil, këtë pozitë ende nuk e kemi plotësuar dhe do të vazhdojmë që të plotësojmë në vitin e 2017.

